



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr.66**

**2004**

**21 shtator**

### P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM  
nr.562, datë 27.8.2004

Për miratimin e marrëveshjes me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës të Republikës së Shqipërisë dhe OMV (Albanien) Adriatic sea Exploration GmbH e Lundin Netherlands B.V, për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në bllokun “Durrësi” në detin shqiptar..... 4089

**VENDIM**  
**Nr.562, datë 27.8.2004**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME NDARJE PRODHIMI, NDËRMJET  
MINISTRISË SË INDUSTRIISË DHE TË ENERGJETIKËS TË REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË DHE OMV (ALBANIEN) ADRIATIC SEA EXPLORATION GMBH E  
LUNDIN NETHERLANDS B.V., PËR KËRKIMIN DHE PRODHIMIN E  
HIDROKARBUREVE NË BLOKUN “DURRËSI” NË DETIN SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 13 të ligjit nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes me ndarje prodhimi, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës së Republikës të Shqipërisë dhe shoqërive OMV (Albanien) Adriatic Sea Exploration GmbH e Lundin Netherlands B.V., për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në bllokun “Durrësi” në detin shqiptar, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Fatos Nano**

**MARRËVESHJE**

**ME NDARJE PRODHIMI PËR KËRKIMIN DHE PRODHIMIN E HIDROKARBUREVE NË  
BLOKUN “DURRËSI” NË DETIN SHQIPTAR NDËRMJET MINISTRISË SË INDUSTRIISË  
DHE TË ENERGJETIKËS TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE OMV (ALBANIEN)  
ADRIATIC SEA EXPLORATION GMBH DHE LUNDIN NETHERLANDS B.V.**

Kjo kontratë është bërë dhe arritur në Tiranë, Republika e Shqipërisë, më 27.5. 2004, ndërmjet Ministrisë së Industrisë dhe të Energjetikës të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve (këtu e më poshtë e quajtur “AKH”), nga njëra anë, dhe OMV (ALBANIEN) Adriatic Sea Exploration GmbH, një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Austrisë, zyra e regjistruar e së cilës ndodhet në Gerasdorferstraße 15 1,1210 Vienë, Austri (këtu e më poshtë e quajtur “OMV”) dhe Lundin Netherlands B.V., një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të Holandës, zyra e regjistruar e së cilës ndodhet në Amaliastraat 3-5, 2514 JC, Hagë, Holandë (këtu e më poshtë e quajtur “Lundin”), nga ana tjetër.

**PARATHËNIE**

Ndërsa operacionet hidrokarbure në Republikën e Shqipërisë qeverisen nga ligji nr.7746, datë 28.7.1993, siç është amenduar nga ligji nr.7853, datë 29.7.1994 dhe nga ligji nr. 8297, datë 4.3.1998, të gjithë së bashku të cituar si “ligji i hidrokarbureve 1993 (Kërkimi dhe prodhimi)”; nga dekreti nr.782, datë 22.2.1994 “Për sistemin fiskal në sektorin e hidrokarbureve (kërkimi dhe prodhimi)”, të miratuar me ndryshime me ligjin nr.7811, datë 12.4.1994 “Për miratimin e dekretit nr.782” dhe nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr.445, datë 3.9.1993 “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve,” (të gjithë dokumentet ligjore të sipërpërmendura, bashkërisht quhen edhe “ligji hidrokarbur”);

ndërsa, Republika e Shqipërisë është pronare e vetme e gjithë burimeve natyrore brenda territorit dhe e zonave të saj detare dhe ka të drejtën të kërkojë, të zhvillojë, të nxjerrë, të prodhojë dhe të shfrytëzojë burimet natyrore;

ndërsa, Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve është përgjegjëse për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve brenda Republikës së Shqipërisë;

ndërsa, Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve, në emër të ministrisë, ka të drejtën ekskluzive të hyjë në marrëveshje me Kontraktorin për kryerjen e operacioneve hidrokarbure të përshkruara në kontratë;

ndërsa, Kontraktori bie dakord që të plotësojë detyrimet e tij si Kontraktor, siç theksohen këtu, në lidhje me operacionet hidrokarbure të përcaktuara në këtë kontratë;

ndërsa, secila nga Palët ka të drejtën, fuqinë dhe autoritetin të hyjë në këtë kontratë;

ndërsa, AKH-ja dhe Kontraktori së bashku dëshirojnë të hyjnë në këtë Kontratë në lidhje me “zonën e kontratës”;

Tani, prandaj Palët këtu bien dakord për sa vijon:

## Neni 1 Përkufizime

Në këtë kontratë, fjalët në njëjës përfshijnë edhe shumësin dhe anasjelltas, dhe përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, termat që vijojnë do të kenë kuptimin që iu është dhënë si më poshtë:

1.1 “Procedura llogaritëse” do të thotë procedurat dhe raportimet e kërkuara, siç përcaktohen në aneksin “C”.

1.2 “Filial” do të thotë, në lidhje me AKH-në ose ndonjërin prej kompanive, një kompani ose një korporatë:

i) që është, direkt ose indirekt, e kontrolluar prej asaj njësie;

ii) që, direkt ose indirekt, kontrollon atë njësi;

iii) që është, direkt ose indirekt, e kontrolluar prej një kompanie ose korporate që gjithashtu, direkt ose indirekt, kontrollon atë njësi.

Për qëllimet e këtij përkufizimi, një kompani është direkt e kontrolluar prej një kompanie që zotëron aksione në atë sasi që përbëjnë shumicën e votave të ushtruara në një mbledhje të përgjithshme të kompanisë së përmenduar më parë ose të drejtën e emërimit apo shkarkimit të drejtuesve të saj; dhe një kompani e veçantë është indirekt e kontrolluar prej një kompanie (që këtu e më poshtë do të quhet “kompania mëmë”), nëse një sërë kompanish mund të specifikohen, duke filluar me kompaninë mëmë dhe duke përfunduar me kompaninë e veçantë të lidhura në mënyrë të tillë që çdo kompani e serisë, përveç kompanisë mëmë, është direkt e kontrolluar nga një ose më shumë prej kompanive të mëparshme të serisë.

1.3 “Periudha e vlerësimit” do të thotë periudha të cilën Kontraktori e gjykon të domosdoshme për të përcaktuar nëse një zbulim është zbulim komercial dhe me zbulimin komercial kjo periudhë do të vazhdojë deri në fillimin e periudhës së zhvillimit dhe prodhimit. Faza e studimit teknik dhe të marketimit, në përputhje me nenin 7.7 dhe ndonjë periudhë e mbajtjes, në përputhje me nenin 7.8 do të jenë pjesë të periudhës së vlerësimit.

1.4 “Program vlerësimi” do të thotë një program i dorëzuar prej Kontraktorit sipas nenit 7, sipas të cilit Kontraktori do të vlerësojë dhe do të përshkruajë një ose disa zbulime.

1.5 “Pus vlerësimi” do të thotë çdo pus, qëllimi i të cilit në momentin e fillimit të shpimit është përcaktimi i komercialitetit të një zbulimi ekzistues.

1.6 “Gaz shoqërues” do të thotë gaz natyror, që shoqëron naftën brut, nëse kjo naftë brut mund të prodhohet më vete në mënyrë komerciale.

1.7 “Hidrokarburet e disponueshme, do të thotë sasi të prodhimit ditor të hidrokarbureve nga zona e kontratës (minus ndonjë sasi të përdorur në operacionet hidrokarbure, të djegur ose të injektuar) të prodhuara, të ruajtura dhe të matura në pikën e matjes. Hidrokarbure të disponueshme do të thotë dhe përfshin çdo sasi të naftës brut dhe/ose gazit natyror që në këtë rast do të quhet “naftë brut e disponueshme” dhe/ose “gaz natyror i disponueshëm”, sipas rastit.

1.8 “Barrel” do të thotë një sasi naftë bruto e barabartë me 158 987 litra në presion atmosferik standard prej 101325 bar dhe temperaturë gjashtëdhjetë gradë Fahrenheit (60°F).

1.10 “Bllok” do të thotë zona e kontratës siç përshkruhet në aneksin “A” dhe siç tregohet në hartën bashkëlidhur si aneksi “B”.

1.11 “BOE” do të thotë ekuivalent barrele naftë. Ekuivalenti i një barrele naftë brut përmban 5.8 milionë BTU vlerë kalorifike bruto, ku BTU-ja përfaqëson njësinë termike Britanike, që përfaqëson nxehtësinë e kërkuar për të çuar temperaturën e një paundi ujë nga 58.50 F në 59.5°F në një presion standard prej 30 polliç shtyllë zhive.

1.12 “Buxhet” do të thotë një vlerësim i të ardhurave dhe i shpenzimeve.

1.13 “Vit kalendarik” do të thotë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajsh të njëpasnjëshëm që fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor që pason, në përputhje me kalendarin Gregorian.

1.14 “Fillimi i prodhimit komercial” do të thotë, në lidhje me çdo zonë zhvillimi dhe prodhimi, dita e fundit e tridhjetë (30) ditëve të para, gjatë secilës, prej të cilave është realizuar prodhimi i rregullt dhe i vazhdueshëm i naftës brut, siç është përcaktuar në planin e zhvillimit (duke përfshirë prodhimin gjatë testimit) ose ditën e fundit të tridhjetë (30) ditëve të para gjatë secilës prej të cilave janë realizuar shitje të rregullta e të vazhdueshme të gazit natyror.

1.15 “Zbulim komercial” do të thotë një zbulim të cilin Kontraktori, pas kryerjes së operacioneve të vlerësimit të përcaktimit të sasisë dhe cilësisë së hidrokarbureve prezente, vendin dhe thellësinë e ndodhjes së tyre, shpenzimet potenciale të kërkuara, çmimet që dominojnë në tregjet botërore dhe faktorë të tjerë të ndërlidhur, vendos ta zhvillojë dhe ta vejë në prodhim.

1.16 “Kompani” do të thotë secila prej kompanive të cilat kohë mbas kohe përbëjnë Kontraktorin.

1.17 “Kontratë” do të thotë kjo kontratë me ndarje prodhimi për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve.

1.18 “Kontraktor” do të thotë OMV dhe Lundin dhe pasuesit ose marrësit e interesave të tyre respektive në përputhje me nenin 21.

1.19 “Zonë kontrate” do të thotë:

1.19.1 në datën efektive, zona detare e përshkruar në aneksin “A” dhe e treguar në hartën e aneksit “B”;

1.19.2 më pas, e gjitha ose një pjesë e kësaj zone detare në lidhje me të cilën në çdo lloj kohe Kontraktori vazhdon të ketë të drejta dhe detyrime sipas kësaj kontrate.

1.20 “Vit kontraktor” do të thotë një periudhë prej dymbëdhjetë (12) muajsh (normalisht të përbëra nga treqind e gjashtëdhjetë e pesë (365) ditë të njëpasnjëshme) që fillon në datën efektive.

1.21 “Llogaria e kostos” do të thotë tërësia e llogarive që mbahen prej Kontraktorit në përputhje me parashikimet e procedurës llogaritëse, që tregon debitë, kreditë dhe transaksionet e tjera, që rezultojnë në lidhje me operacionet hidrokarbure.

1.22 “Hidrokarbure kosto” do të thotë hidrokarbure prej të cilave Kontraktori ka të drejtën të rikuperojë kostot dhe shpenzimet e operacioneve hidrokarbure në përputhje me nenin 9.

1.23 “Naftë brut” do të thotë minerali naftë brut, faza hidrokarbure në kokën e kezingut dhe gjithë llojet e hidrokarbureve të lëngëta, por nuk përfshin gaz kondensatet, qymyrin ose ndonjë substancë tjetër të lëngshme që mund të nxirret prej qymyrit.

1.24 “Pikë livrimi” do të thotë pika(t) siç përcaktohet respektivisht në planin e zhvillimit, e që mund të jetë edhe jashtë zonës së kontratës.

1.25 “Zonë zhvillimi dhe prodhimi” do të thotë zona ose zonat e vendosura prej Kontraktorit, në përputhje me nenin 8, duke njoftuar AKH-në me shkrim që Kontraktori ka bërë një zbulim komercial dhe duke paraqitur një hartë që përshkruan një zonë që përfshin të gjithë ose një pjesë të zonës së zbulimit, që Kontraktori beson se përmban zbulimin komercial. Me përcaktimin e saj, zona e zhvillimit dhe e prodhimit do të shtrihet në të gjithë thellësitë brenda kufijve të saj anësor.

1.26 “Periudha e zhvillimit dhe e prodhimit” do të thotë, në lidhje me secilën zonë zhvillimi dhe prodhimi, periudha e specifikuar në nenin 3.

1.27 “Plan zhvillimi” do të thotë një plan për zhvillimin e një zbulimi komercial të përgatitur prej Kontraktorit dhe të aprovuar në përputhje me nenin 8, duke përfshirë edhe ndonjë amendament të tij.

1.28 “Zbulim” do të thotë zbulimi i një grumbullimi apo i grumbullimeve të hidrokarbureve në zonën e kontratës.

1.29 “Zonë zbulimi” do të thotë një zonë ose zonat, të cilat Kontraktori mund t’i vendosë duke njoftuar me shkrim AKH-në që Kontraktori ka bërë një zbulim, e duke i dhënë AKH-së një hartë që tregon vendosjen e kufijve të një zone që përbën një pjesë të zonës së kontratës, ku Kontraktori beson se përfshihet zbulimi. Me përcaktimin e saj sipas nenit 7, një zonë zbulimi do të shtrihet në të gjithë thellësitë brenda kufijve të saj anësor.

1.30 “Datë efektive” do të thotë data në të cilën Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin e hidrokarbureve, nxjerr një vendim që miraton këtë kontratë, e që pas kësaj kjo kontratë do të marrë forcë ligjore. AKH-ja do të njoftojë Kontraktorin mbi miratimin e Këshillit të Ministrave brenda pesë ditëve pune, nga data e këtij miratimi.

1.31 “Hidrokarbure kosto teprice” do të thotë sasi të hidrokarbureve të përcaktuara në përputhje me nenin 10.

1.32 “Ekspert” do të thotë një individ i cili nuk është as rezident e as shtetas shqiptar dhe nuk ka qenë i punësuar as prej Kontraktorit e as prej AKH-së dhe që, nëpërmjet trainimit e eksperiencës së gjerë, ka zhvilluar në shkallë të lartë njohuritë në fushat teknike, brenda të cilave përfshihet polemika ose mosmarrëveshja të cilën ai ka për të zgjidhur dhe që është emëruar sipas parashikimeve të nenit 24.10.

1.33 “Operacione kërkimi” do të thotë operacionet hidrokarbure të cilat janë kryer sipas kësaj kontrate gjatë periudhës së kërkimit për ose në lidhje me kërkimin e hidrokarbureve duke përfshirë, pa u kufizuar, vrojtimit dhe studimet gjeologjike, gjeofizike e të tjera, rishikimin, përpunimin dhe analizimin e të dhënave, shpimin e puseve kërkimore, planifikimet që lidhen me to, desinjimet, operacionet administrative, inxhinierike, të konstruktive dhe të mirëmbajtjes dhe gjithë operacionet dhe aktivitetet e tjera siç referohen në aneksin “C” apo ndryshe të parashikuara sipas kushteve të kësaj kontrate.

1.34 “Periudhë kërkimi” do të thotë periudha e parë e kërkimit, periudha e dytë e kërkimit dhe periudha e tretë e kërkimit.

1.35 “Pus kërkimor” do të thotë qoftë një pus prove, qoftë një pus vlerësimi.

1.36 “Periudha e parë e kërkimit” do të thotë një periudhë prej katër (4) vitesh kontraktore, prej datës efektive, së bashku me ndonjë shtesë të kësaj periudhe të parashikuar sipas termave të kësaj kontrate.

1.37 “Pikë matje” do të thotë ajo pikë, siç përshkruhet në një plan zhvillimi, ku hidrokarburet maten me qëllim përcaktimin e hidrokarbureve të disponueshme.

1.38 “Gaz natyror” do të thotë të gjitha hidrokarburet e gazta (joshqëruese dhe shoqëruese) të prodhuara nga pusët, duke përfshirë mineralin e gazit të lëngët, mineralin e gazit të thatë, gazin e kokës së kezingut, lëngjet e gazit natyror, gaz kondensatin, gazin e mbetur mbas nxjerrjes ose ndarjes së hidrokarbureve të lëngëta nga gazi i lëngët.

1.40 “Gaz joshqërues” është gazi natyror i ndryshëm nga gazi shoqërues.

1.39 “Operator” do të thotë një njësi e caktuar, në përputhje, me parashikimet e nenit 5 këtu, i cili do të jetë përgjegjës për kryerjen e operacioneve hidrokarbure në zonën e kontratës ose në ndonjë pjesë të saj sipas termave të kësaj kontrate.

1.40 “Interesa pjesëmarrje” do të thotë interesat respektive e të pandashme që secila prej kompanive herë pas here ka mbi të gjitha të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë nën këtë kontratë.

1.41 “Palë” ose “Palët” do të thotë AKH-ja ose Kontraktori ose që të dy së bashku.

1.42 “Hidrokarbure” do të thotë dhe përfshin të dyja, naftën brut dhe gazin natyror.

1.43 “Operacione hidrokarbure” do të thotë të gjitha operacionet e kryera prej Kontraktorit, sipas kësaj kontrate në zonën e kontratës deri në pikën e livrimit, duke përfshirë e pa u limituar, operacionet e kërkimit, operacionet e zhvillimit e prodhimit, përfshirë përpunimin e hidrokarbureve që do të përdoren në operacionet hidrokarbure, transportimin dhe përpunimin e hidrokarbureve dhe operacionet e abandonimit, të gjitha operacionet shoqëruese të planifikimit, desinjimit, administrimit, inxhinierisë, konstruktimit dhe mirëmbajtjes dhe çdo operacion e aktivitet të parashikuar sipas kushteve të kësaj kontrate, por nuk përfshijnë operacionet e rafinimit të hidrokarbureve.

1.44 “Kostot e operacioneve hidrokarbure” do të thotë të gjitha kostot dhe shpenzimet e krijuara dhe të kryera prej Kontraktorit për ose në lidhje me kryerjen e operacioneve hidrokarbure sipas kësaj kontrate, të përcaktuara dhe të përlogaritura në përputhje me procedurën llogaritëse.

1.45 “Tremujor” do të thotë një periudhë e tre muajve të njëpasnjëshme që fillojnë në ditën e parë të janarit, prillit, korrikut dhe tetorit në çdo vit kalendarik.

1.46 “Periudha e dytë e kërkimit” do të thotë një periudhë prej një (1) viti kontraktor që prej përfundimit të periudhës së parë të kërkimit, së bashku me ndonjë shtesë të saj të parashikuar sipas termave të kësaj kontrate.

1.47 “Periudha e tretë e kërkimit” do të thotë një periudhë prej dy (2) vitesh kontraktore që prej përfundimit të periudhës së dytë të kërkimit, së bashku me ndonjë shtesë të saj të parashikuar sipas termave të kësaj kontrate.

1.48 “Skema e zhvillimit të përbashkët” ka kuptimin që i është dhënë asaj në nenin 14.

1.49 “US\$“ ose “dollarë amerikanë” do të thotë dollarë të Shteteve të Bashkuara, që është monedha ligjore e Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

1.50 “Pus prove” do të thotë një pus i cili është vendosur në një strukturë gjeologjike, prej së cilës nuk janë zbuluar më parë hidrokarbure në sasi komerciale.

1.51 “Program pune” do të thotë një program për operacionet hidrokarbure që do të kryhen brenda ose në lidhje me zonën e kontratës, zonën e zbulimit ose zonën e zhvillimit dhe të prodhimit, si dhe afatet kohore për to.

## Neni 2

### **Qëllimi i marrëveshjes, interesat e pjesëmarrjes**

2.1 Kjo kontratë është një marrëveshje me ndarje prodhimi për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin dhe ajo do të mbulojë operacionet hidrokarbure në zonën e kontratës deri në pikën e livrimit. Të drejtat dhe detyrimet e palëve nën këtë kontratë do të hyjnë në fuqi që prej datës efektive.

2.2 Në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj kontrate, AKH-ja do të caktojë dhe do të emërojë në mënyrë të përvokueshme Kontraktorin, në mënyrë të vetme dhe ekskluzive, që të kryejë operacione hidrokarbure në zonën e kontratës dhe deri në pikën e livrimit brenda periudhës së specifikuar këtu.

2.3 Kontraktori do të jetë përgjegjës para AKH-së për kryerjen e operacioneve hidrokarbure në përputhje me klauzolat e kësaj kontrate. Pa paragjykuar pozicionin e Kontraktorit si një Kontraktor i pavarur, sasia dhe karakteri i punës për t’u bërë nga Kontraktori do të jenë subjekt i rishikimit dhe aprovimit të AKH-së për aq sa parashikohet në këtë kontratë.

2.4 Në kryerjen e operacioneve hidrokarbure, Kontraktori do të sigurojë të gjitha kërkesat teknike dhe financiare dhe do të përdorë metodat, procedurat, teknologjitë dhe pajisjet përgjithësisht të pranuar në industrinë ndërkombëtare të naftës.

2.5 Kontraktori do të kryejë operacionet hidrokarbure me riskun dhe kostot e tij, përveçse kur në këtë kontratë parashikohet shprehimisht ndryshe.

2.6 Në qoftë se nuk është e shprehur ndryshe këtu ose, në qoftë se nuk është rënë dakord me shkrim, Kontraktori nuk do të marrë kompensim për shërbimet e tij, as ndonjë rimbursim për shpenzimet e tij sipas kësaj kontrate, me përjashtim të pjesës së tij të hidrokarbureve nga zona e kontratës për të cilën atij i jepet e drejta, në përputhje me nenet 9,10 dhe 11.

2.7 Gjatë afatit të kësaj kontrate, të gjitha hidrokarburet e prodhuara nga zona e kontratës do të ndahen ndërmjet AKH-së dhe Kontraktorit në përputhje me klauzolat e mëposhtme.

2.8 Kjo kontratë nuk i jep Kontraktorit të drejtën e pronësisë mbi hidrokarburet në shtresë në zonën e kontratës. Megjithatë, Kontraktori do të ketë të drejtën të marrë në natyrë, të zotërojë dhe të eksportojë lirisht pjesën e tij të hidrokarbureve nga zona e kontratës në përputhje me klauzolat e kësaj kontrate. E drejta dhe risku mbi pjesën e hidrokarbureve të Kontraktorit do të kalojë te Kontraktori në pikën e përshtatshme të livrimit.

2.9 Interesat e pjesëmarrjes së kompanive në datën efektive janë si më poshtë:

OMV 50% (pesëdhjetë për qind)

Lundin 50% (pesëdhjetë për qind)

### Neni 3 Afatet

3.1 Në qoftë se nuk përfundohet më shpejt në përputhje me afatet e mëposhtme, kjo kontratë do të mbesë në fuqi gjatë periudhës së kërkimit, ndonjë periudhe vlerësimi dhe ndonjë periudhe zhvillimi dhe prodhimi.

3.2 Kontraktori mundet, me zgjedhjen e tij të vetme, të hyjë në periudhën e dytë ose të tretë të kërkimit, duke i dhënë AKH-së, të paktën gjashtëdhjetë (60) ditë përpara përfundimit të periudhës së parë ose të dytë të kërkimit, siç mund të jetë rasti, njoftimin se ai ka për qëllim të hyjë në periudhën e dytë ose të tretë të kërkimit. Në qoftë se Kontraktori nuk e jep një njoftim të tillë, atëherë në përputhje me nenin 3.3, kjo kontratë do të mbarojë automatikisht në fund të periudhës së parë të kërkimit ose periudhës së dytë të kërkimit (siç mund të jetë rasti).

3.3 Në qoftë se operacionet e shpimit, duke përfshirë testimin, janë në vazhdim në fund të afatit të periudhës së parë të kërkimit, periudhës së dytë të kërkimit ose të periudhës së tretë të kërkimit, atëherë kjo periudhë do të zgjatet automatikisht deri gjashtëdhjetë (60) ditë mbas kryerjes së këtyre operacioneve të shpimit.

3.4 Në qoftë se Kontraktori ka bërë një zbulim gjatë periudhës së parë të kërkimit, periudhës së dytë të kërkimit ose periudhës së tretë të kërkimit, atëherë periudha në fjalë do të zgjatet automatikisht për zonën e zbulimit të përcaktuar, në përputhje me nenin 7 për një periudhë vlerësimi. Periudha e vlerësimit do të zgjasë për një periudhë të tillë siç kërkohet për vlerësimin, duke marrë në konsideratë rrethanat mbizotëruese të zbulimit dhe standardet përgjithësisht të pranuar në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare të vendburimeve të naftës dhe gazit. Periudha për realizimin e programit të vlerësimit mund të zgjatet nga Kontraktori, në qoftë se aspektet operacionale e kërkojnë një gjë të tillë dhe në qoftë se justifikohet në mënyrë të arsyeshme nëpërmjet amendimit të programit të vlerësimit.

3.5 Një periudhë zhvillimi dhe prodhimi do të fillojë, në lidhje me çdo zonë zhvillimi dhe prodhimi, në datën që një plan zhvillimi për një zonë zhvillimi dhe prodhimi është aprovuar dhe do të vazhdojë deri në përfundimin e njëzet e pesë (25) vjetëve nga data e fillimit të prodhimit komercial nga ajo zonë zhvillimi dhe prodhimi.

3.6 Pa i kufizuar të drejtat e Palëve sipas nenit 17, në rastin kur Kontraktori ndalohet ose pengohet në kryerjen e operacioneve hidrokarbure ose nga e drejta e hyrjes në zonën e kontratës për arsye të lidhura me mbrojtjen e personelit, nënkontraktorëve ose pronave, ose për probleme të importit të pajisjeve, jashtë kontrollit të Kontraktorit, detyrimet e Kontraktorit do të pezullohen që nga koha e fillimit të një pengesë të tillë e deri kur kjo pengesë të jetë hequr. Sa më parë që të jetë praktike pas kësaj, Palët do të takohen dhe do të bien dakord për një periudhë kohe që do t'i shtohet periudhës së parë të kërkimit, periudhës së dytë të kërkimit, periudhës së tretë të kërkimit, periudhës së vlerësimit (siç mund të jetë rasti) dhe ndonjë periudhe zhvillimi dhe prodhimi, kohë e cila do të jetë ekuivalente me periudhën e kohës së nevojshme për kthimin e operacioneve hidrokarbure në gjendjen që ato kishin në kohën e fillimit të pengesës. Në qoftë se pengesa për kryerjen e operacioneve hidrokarbure të përshkruara më sipër do të vazhdojë për një periudhë kohe që do të kalojë gjashtë (6) muaj, Kontraktori do të ketë të drejtën të zgjedhë përfundimin e kësaj kontrate, duke i dhënë AKH-së njoftim me shkrim tridhjetë (30) ditë para dhe Kontraktori do të jetë i shkarkuar nga të gjitha detyrimet sipas kësaj kontrate.

3.7 Me përfundimin e një periudhe zhvillimi dhe prodhimi, Kontraktori ka të drejtë të kërkojë nga AKH-ja një zgjatje të periudhës së zhvillimit dhe prodhimit për periudha të njëpasnjëshme prej pesë (5) vjetësh me të njëjtat kushte siç parashikohet këtu. Aprovimi i AKH-së për zgjatje të tilla, nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme, në qoftë se Kontraktori mund t'i provojë AKH-së që rezervuari(et) është (janë) akoma i aftë të vazhdojë prodhimin.

## Neni 4 Heqja dorë

4.1 Në qoftë se në përputhje me nenin 6.7 (i) Kontraktori është angazhuar të shpojë:

i) një (1) pus të detyrueshëm gjatë periudhës së parë të kërimit dhe vendos të hyjë në periudhën e dytë të kërimit, atëherë Kontraktori do të heqë dorë nga tridhjetë e pesë për qind (35%) të sipërfaqes së zonës së kontratës në përfundim të periudhës së parë të kërimit;

ii) dy (2) puse të detyrueshëm dhe zgjedh të hyjë në periudhën e dytë të kërimit, Kontraktorit nuk do t'i kërkohet të heqë dorë nga asnjë pjesë e zonës së kontratës.

Në qoftë se Kontraktori zgjedh të hyjë në periudhën e tretë të kërimit, atëherë Kontraktori do të heqë dorë nga njëzet për qind (20%) të zonës së kontratës në fund të periudhës së dytë të kërimit. Pjesa e mbetur e zonës së kontratës do të mbahet nga Kontraktori.

Në përcaktimin e numrit të kilometrave katrore nga të cilat do të hiqet dorë, numri i kilometrave katrore që qarkohet nga ndonjë zonë zbulimi ose ndonjë zonë zhvillimi dhe prodhimi do të zbritet nga kilometrat katrore totale të bllokut, siç mund të jetë praktike.

4.2 Në fund të periudhës së tretë të kërimit, do të hiqet dorë nga e gjithë zona fillestare e kontratës, përveç zonës së zbulimit dhe zonës së zhvillimit dhe prodhimit.

4.3 Kontraktori do të heqë dorë nga një zonë zbulimi, në qoftë se ai nuk njofton AKH-në për një zbulim komercial ose për zgjedhjen e tij për të mbajtur zonën e zbulimit ose për zgjedhjen e tij për të hyrë në një fazë të studimit teknik dhe të marketimit. Heqja dorë do të bëhet efektive tridhjetë (30) ditë pas paraqitjes së raportit si parashikohet në nenin 7.5.

4.4 Kontraktori do të heqë dorë nga ndonjë zonë zbulimi të mbajtur në përputhje me nenin 7.8, në qoftë se ai nuk ka deklaruar një zbulim komercial para përfundimit të periudhës së mbajtjes së shpjeguar këtu.

Kontraktori në çdo kohë mund të heqë dorë vullnetarisht nga të drejtat e tij për të kryer operacione hidrokarbure në të gjithë ose në një pjesë të zonës së kontratës. Një heqje dorë e tillë e vullnetshme për më pak se e gjithë zona e kontratës do të kreditohet përkundrejt ndonjë heqje dore të mëtejshme të detyrueshme.

4.6 Asnjë heqje dorë nuk do ta çlirojë Kontraktorin nga detyrimet minimale të paplotësuara sipas nenit 6.

4.7 Të paktën tridhjetë (30) ditë përpara datës së një heqje dore sipas nenit 4.1 ose 4.5, Kontraktori do të njoftojë AKH-në për porcionet e zonës së kontratës nga të cila do të hiqet dorë dhe do ta garantojë që çdo porcion individual i zonës së kontratës nga e cila hiqet dorë, do të jetë aq sa të jetë e mundur në mënyrë të arsyeshme, në madhësi dhe në formë të mjaftueshme për të lejuar kryerjen e operacioneve hidrokarbure.

4.8 Përveç sa parashikohet në nenin 7.9 dhe 7.10 në datën në të cilën ndonjë heqje dorë duhet të kryhet ose duhet bërë efektive ose me përfundimin e kësaj kontrate, Kontraktori nuk do të ketë të drejta ose detyrime të mëtejshme në lidhje me zonat nga të cilat hiqet dorë; megjithatë çdo përgjegjësi mbi Kontraktorin përpara datës së sipërpërmendur do të vazhdojë të ekzistojë përveçse që prej datës së përfundimit të kontratës derisa AKH-ja ta ketë çliruar Kontraktorin me shkrim, çlirim i cili nuk do të vonohet ose refuzohet përveçse kur Palët kanë hyrë në arbitrazh në përputhje me nenin 24 në lidhje me ndonjë detyrim të diskutueshëm.

## Neni 5 Kryerja e operacioneve

### 5.1 Komiteti Këshillimor

5.1.1 Me qëllim zbatimin e duhur të kësaj kontrate, Palët do të krijojnë një Komitet Këshillimor ("Komiteti Këshillimor") brenda dyzet e pesë (45) ditëve nga data efektive. Komiteti Këshillimor do të ketë për detyrë siç përcaktohet në nenin 5.1.5.

5.1.2 AKH-ja dhe Kontraktori do të caktojnë secili nga tre (3) përfaqësues dhe tre (3) përfaqësues alternativë për të formuar Komitetin Këshillimor dhe çdo Palë do të caktojë njërin nga përfaqësuesit e vet si kryetar përfaqësues. Të gjithë përfaqësuesit e sipërpërmendur do të kenë të



drejtë të paraqesin idetë e tyre mbi propozimet në mbledhjet e mbajtura prej komitetit këshillimor dhe të japin votën e tyre kur duhet të merret ndonjë vendim. Kryetari i Komitetit Këshillimor do të jetë kryetari përfaqësues i caktuar nga Kontraktori dhe zëvendëskryetar do të jetë kryetari përfaqësues i AKH-së. Kryetari i Komitetit Këshillimor do të drejtojë mbledhjet e Komitetit Këshillimor. Çdo përfaqësues do të ketë një votë në të gjitha takimet e Komitetit Këshillimor. Palët në përputhje me nevojat, të caktojnë një numër të arsyeshëm pjesëmarrësish të tjerë (duke përfshirë përfaqësuesit e kompanive që nuk janë të përfaqësuara direkt në Komitetin Këshillimor), të cilët mund të marrin pjesë, por nuk do të kenë të drejtë të votojnë në mbledhjet e Komitetit Këshillimor. Secila Palë do t'i japë tjetrës emrat e përfaqësuesve të saj brenda tridhjetë (30) ditësh nga data efektive dhe do të japë njoftim me shkrim për zëvendësimin e këtyre përfaqësuesve. Përfaqësuesit alternativë do të jenë zëvendës të përfaqësuesve të tyre kryesore në mungesë të këtyre të fundit.

5.1.3 Me qëllim që të jetë i vlefshëm, çdo vendim i Komitetit Këshillimor duhet të ketë votën pohuese e të paktën katër (4) anëtarëve të pranishëm në mbledhje, duke nënkuptuar që një vendim i tillë nuk do të jetë i vlefshëm po të mos jenë prezent në mbledhje të paktën dy (2) përfaqësues si të AKH-së ashtu dhe të Kontraktorit. Vendimet e marra nga Komiteti Këshillimor do të regjistrohen dhe nënshkruhen në emër të të dyve, AKH-së, dhe Kontraktorit, në fund të çdo takimi të tillë të Komitetit Këshillimor. Kontraktori do të përgatisë procesverbalin e mbledhjes brenda tridhjetë (30) ditëve mbas saj dhe do ta shpërndajë atë për miratimin e Palëve. Neglizhimi i njerës Palë për t'u përgjigjur brenda njëzet e një (21) ditëve nga marrja e procesverbalit do të konsiderohet si miratim i asaj Pale.

5.1.4 Komiteti Këshillimor do të mbledhet të paktën një herë në çdo vit kalendarik dhe kurdoherë që të kërkohet nga AKH-ja ose nga Kontraktori, subjekt i njoftimit të anëtarëve të tij 15 ditë para, njoftim i cili do të përfshijë axhendën e mbledhjes. Materialet do t'u dërgohen anëtarëve të Komitetit Këshillimor të paktën një javë përpara mbledhjes.

Vendimet e Komitetit Këshillimor mund të merren nëpërmjet një rezolute me shkrim të firmosur nga të gjashtë përfaqësuesit ose përfaqësuesit alternativë respektive të tyre.

5.1.5 Komiteti Këshillimor do të ketë funksionet dhe përgjegjësitë e mëposhtme sipas kësaj kontrate:

5.1.5.1 të garantojë mundësi dhe të inkurajojë shkëmbimin e informacionit, opinionëve, ideve dhe sugjerimeve në lidhje me planet, realizimet dhe rezultatet e marra nga zbatimi i kontratës;

5.1.5.2 të rishikojë parimet e përcaktuara nga Kontraktori, kohë pas kohe, për drejtimin e aspekteve ose aktiviteteve të ndryshme të operacioneve hidrokarbure dhe të propozojë, për këtë qëllim, procedura dhe direktiva, siç mund t'i gjykojë të nevojshme;

5.1.5.3 të rishikojë dhe të miratojë nëse programet e punës dhe buxhetet e propozuara nga Kontraktori janë brenda qëllimit të marrëveshjes në përputhje me nenin 2 dhe të propozojë rishikime në përputhje me nenin 6.4;

5.1.5.4 në rastin e një zbulimi, të rishikojë propozimet për vlerësimin dhe zhvillimin e mundshëm të një zbulimi të tillë;

5.1.5.5 të rishikojë një plan zhvillimi;

5.1.5.6 të bashkëveprojë në drejtim të zbatimit të kontratës në përputhje me termat e saj;

5.1.5.7 çdo funksion tjetër siç mund t'i autorizohet atij prej Palëve.

5.2 Operatori

5.2.1 Kontraktori do të zgjedhë një kompani që të veprojë si operator i cili do të kryejë operacionet hidrokarbure në zonën e kontratës në përputhje me praktikat e mira ndërkombëtare të vendburimeve të naftës;

5.2.2 OMV caktohet këtu si operator;

5.2.3 Caktimi i një pasuesi të operatorit do të jetë subjekt i aprovimit paraprak të AKH-së, duke parashikuar që një aprovim i tillë nuk kërkohet dhe vetëm një njoftim me shkrim do të jepet, në qoftë se pasardhësi i operatorit është një kompani ose është një filial i një kompanie në atë kohë.

## Neni 6

### Programet e punës, buxhetet dhe detyrimet e punës

6.1 Në qoftë se nuk parashikohet ndryshe, Kontraktori do të kryejë operacionet hidrokarbure në përputhje me programet e punës dhe buxhetet e miratuara dhe do të fillojë operacionet hidrokarbure jo më vonë se tre (3) muaj pas datës efektive. Programet e punës dhe buxhetet do të përgatiten në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare të vendburimeve të naftës.

6.2 Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga data efektive, Kontraktori do të përgatisë dhe paraqesë në Komitetin Këshillimor një program pune që tregon operacionet hidrokarbure, të cilat Kontraktori propozon të kryejë gjatë pjesës së mbetur të vitit kalendarik dhe një buxhet në lidhje me të.

6.3 Të paktën gjashtëdhjetë (60) ditë para fundit të vitit të parë kalendarik dhe çdo vit kalendarik të mëvonshëm, ose kohë të tjera të tilla siç është rënë dakord ndërmjet Palëve, Kontraktori do të përgatisë dhe do të paraqesë për rishikim e miratim në Komitetin Këshillimor një program pune dhe buxhet të propozuar për vitin kalendarik pasardhës.

6.4 Programi i punës dhe buxheti do të miratohen nga Komiteti Këshillimor në përputhje me nenin 5.1.5 brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e tij. Megjithatë, në qoftë se përfaqësuesit e AKH-së në Komitetin Këshillimor do të dëshirojnë të propozojnë një rishikim të pjesëve të veçanta të programit të punës dhe buxhetit të mësipërm, kjo duhet bërë brenda tridhjetë (30) ditësh pas marrjes nga Komiteti Këshillimor dhe të njoftojë Kontraktorin, duke specifikuar në detaje të arsyeshme, arsyet e tij. Menjëherë pas kësaj, Palët do të takohen dhe do të bien dakord për të rishikuar propozimin e bërë nga përfaqësuesit e AKH-së.

Kontraktori do t'i kushtojë vëmendjen e duhur propozimeve të përfaqësuesve të AKH-së. Plani i rishikuar i punës dhe buxheti do të miratohen nga Komiteti Këshillimor brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga marrja e tij.

6.5 Nga Palët pranohet që detajet e programit të punës dhe buxhetit mund të kërkojnë ndryshime nën dritën e rrethanave ekzistuese dhe, në këtë rast, Kontraktori do të bëjë ndryshime të tilla duke pasur parasysh që ato nuk ndryshojnë objektivin kryesor të programit të punës. Çdo ndryshim material i programit të punës dhe buxhetit do të miratohet në përputhje me nenin 6.4.

6.6 Është e kuptueshme që në rastin e një situatë emergjente, që kërkon veprim të menjëhershëm, Kontraktori do të ndërmarrë të gjitha veprimet që ai i mendon të përshtatshme ose të këshillueshme për të mbrojtur interesat e tij dhe ato të punonjësve të tij dhe ndonjë kosto e kryer për këtë do të përfshihet në kostot e operacioneve hidrokarbure. Kushte emergjente do të ekzistojnë atëherë kur jeta, shëndeti ose pasuria janë në rrezik nga kushtet ekzistuese ose kushtet potenciale të tilla, si fontana, zjarret, eksplozionet, shembjet, kushte të ashpra moti, veprime lufte, vandalizma ose sabotime.

6.7 Kontraktori do të kryejë programin minimal të kërkimit si vijon:

i) Periudha e parë e kërkimit:

ripërpunimi i një mijë (1000) kilometrave sizmike;

kryerja e katërqind (400) kilometrave katrore sizmike 3D; dhe me zgjedhjen e vet ekskluzive

Kontraktori ose:

- do të shpojë dy (2) puse të detyrueshëm; ose

- do të shpojë një (1) pus të detyrueshëm dhe do të heqë dorë siç është vendosur në nenin

4.1;

ii) Në periudhën e dytë të kërkimit, nëse hyn në përputhje me nenin 3.2:

kryerja e treqind (300) kilometrave katrore sizmike 3D;

iii) Në periudhën e tretë të kërkimit, nëse hyn në përputhje me nenin 3.2:

shpimi i një (1) pusi të detyrueshëm.

6.8 Në qoftë se në mbarim të periudhës së parë të kërkimit, ose të periudhës së dytë të kërkimit, ose të periudhës së tretë të kërkimit, ose në datën e përfundimit të kësaj kontrate (përveçse në përputhje me nenin 3.6 ose 22.4), ose në heqjen dorë nga e gjithë zona e kontratës nga Kontraktori, cilado që të ndodhë më parë, Kontraktori ka dështuar në kryerjen, në përputhje me këtë kontratë, të të gjithë ose të një pjese të programit minimal të eksplorimit siç përcaktohet në nenin

6.7 (i) ose 6.7 (ii), ose 6.7 (iii), atëherë Kontraktori, me kërkesën e AKH-së, do t'i paguajë AKH-së shumat e mëposhtme:

për çdo kilometër sizmike të papërpunuar, njëqind dollarë amerikanë (US\$ 100.00), (për shmangie të dyshimit, deri në një maksimum prej 1 000 kilometrash në periudhën e parë të kërkimit), dhe

për çdo kilometër katrore sizmike 3D të perealizuar, pesë mijë dollarë amerikanë (US\$ 5 000.00) (për shmangie të dyshimit, deri në një maksimum prej 400 kilometrash katrore në periudhën e parë të kërkimit dhe, nëse hyhet, 300 kilometrash katrore në fazën e dytë të kërkimit), dhe

për çdo pus të detyrueshëm të pashpuar, dy milionë e gjysëm dollarë amerikanë (US\$ 2 500 000.00) (për shmangie të dyshimit, deri në një maksimum prej një pusi të detyrueshëm në periudhën e parë të kërkimit dhe, nëse hyhet, një pusi të detyrueshëm në periudhën e tretë të kërkimit).

Pagesat në përputhje me nenin 6.8 do të kryhen vetëm në lidhje me ndonjë detyrim të paplotësuar të ndonjëres nga periudhat e parë, e dytë ose e tretë të kërkimit, në të cilat Kontraktori ka zgjedhur që të hyjë.

6.9 Në qoftë se gjatë shpimit të një pusi të detyrueshëm, Kontraktori ndesh vështirësi teknike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në mbipresione, të cilat në gjykimin e arsyeshëm të Kontraktorit janë të pamundura për t'u kaluar në pikëpamje të parametrave teknikë ose ekonomikë, atëherë një pus i tillë i detyrueshëm do të konsiderohet i shpuar, duke pasur parasysh që Kontraktori në atë kohë dhe në lidhje me atë pus ka plotësuar detyrimet e shpenzimeve prej një milionë e gjysëm dollarë amerikanë (US\$ 1 500 000.00). Në qoftë se një detyrim i tillë nuk është plotësuar akoma, Kontraktori në dëshirën e tij dhe për plotësimin e plotë të detyrimit të tij, mund t'i paguajë diferencën AKH-së ose të shpojë një pus për të zëvendësuar të parin.

6.10 Në rastin kur AKH-ja ka rënë dakord që Kontraktori të kryejë punë në lidhje me zonën e kontratës përpara datës efektive, kostot e kryera për këto punë do të trajtohen si kosto të operacioneve hidrokarbure dhe puna do të jetë (pjesërisht) plotësim i detyrimit të Kontraktorit në përputhje me nenin 6.7.

6.11 Në rastin kur Kontraktori ndërmer punë (duke përfshirë ripërpunimin sizmik, kryerjen e sizmikës 3D ose shpimin e puseve) që është në shtesë të programit minimal të kërkimit të aplikueshëm për periudhën respektive e të kërkimit, atëherë këto punë shtesë do t'i kreditohen detyrimeve respektive të punës të periudhës(ave) të kërkimit që pasojnë.

6.12 Palët bien dakord që në lidhje me detyrimin minimal të punës së perealizuar në blloqet D dhe E në tokën shqiptare (PSA të miratuara respektivisht me vendimin e Këshillit të Ministrave të Shqipërisë nr.314 të datës 8 korrik 1999 dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr.248 të datës 9 qershor 1994) të vlerësuar me US \$ 2 milionë, Kontraktori me kërkesë të AKH-së do t'i paguajë AKH-së sasinë e mëposhtme:

US \$ 800 000 në rast se Kontraktori nuk kryen katërqind (400) kilometra katrorë sizmike 3D në përputhje me nenin 6.7 (i) dhe në mënyrë të ndërsjellë me nenin 6.8.

US \$ 1 200 000 në rast se Kontraktori nuk shpon një pus në përputhje me nenin 6.7.(i)

Me nënshkrimin e kësaj kontrate, kontrata për blloqet D dhe E të miratuara respektivisht me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.314, datë 8 korrik 1999 dhe me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.248 datë 9 Qershor 1994 do të përfundojnë automatikisht dhe Kontraktori, Kompanitë ose filialet e tyre nuk do të kenë më përgjegjësi ose detyrime në lidhje me detyrimin minimal të punës ose ndonjë detyrim tjetër financiar, përveç atyre që jepen në këtë kontratë

Me marrjen e garancisë së kompanisë mëmë të bërë si duhet në formën e përcaktuar në aneksin D, AKH-ja do t'i çlirojë me shkrim kompanitë dhe filialet prej të gjitha garancive bankare, në lidhje me detyrimet e tyre sipas marrëveshjeve me ndarje prodhimi për blloqet D dhe E.

## Neni 7 Zbulimi dhe vlerësimi

7.1 Kontraktori do të njoftojë AKH-në jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas ndonjë zbulimi të hidrokarbureve brenda zonës së kontratës. Ky njoftim do të përmbledhë të gjitha detajet e disponueshme të zbulimit dhe, në qoftë se është e nevojshme, veçori për ndonjë program testimi që do të ndërmerret.

7.2 Në qoftë se Kontraktori konsideron që një zbulim meriton vlerësim, Kontraktori do të paraqesë në Komitetin Këshillimor, sa më shpejt që të jetë praktikisht e realizueshme, por jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj pas njoftimit të zbulimit në përputhje me nenin 7.1, një program vlerësimi të detajuar dhe buxhet për të vlerësuar nëse zbulimi është një zbulim komercial.

7.3 Programi i vlerësimit do të përshkruajë zonën e zbulimit dhe vendndodhjen, natyrën, shtrirjen dhe vlerësimin e madhësisë e zbulimit dhe do të përfshijë, gjithashtu planin për vlerësimin e zbulimit dhe afatet kohore për kryerjen e programit të vlerësimit. Në rast se zbulimi përfshin volume të konsiderueshme të gazit natyror, programi i vlerësimit do të përfshijë një studim paraprak të tregut për të identifikuar blerësit potencialë të prodhimit të parashikuar. Në mënyrë të veçantë, ky studim i tregut do të analizojë kapacitetin e tregut shqiptar për përdorimin dhe blerjen e gazit natyror dhe termat kryesore të një marrëveshjeje shitje gazi me parashikim të çmimit që mund të realizohet.

7.4 Pas rishikimit të programit të vlerësimit dhe buxhetit, Kontraktori do të vazhdojë të vlerësojë me kujdes zbulimin, në përputhje me një program të tillë, pa ndërprerje të pajustificuara.

7.5 Brenda nëntëdhjetë (90) ditëve pasi është kompletuar vlerësimi, Kontraktori do t'i paraqesë AKH-së një raport mbi rezultatet e programit të vlerësimit. Një raport i tillë do të përfshijë të gjitha të dhënat e përshtatshme teknike dhe ekonomike që lidhen me të. Për më tepër, Kontraktori do të njoftojë AKH-në, nëse Kontraktori deklaron një zbulim komercial ose hyn në një fazë studimi teknik dhe të marketimit në përputhje me nenin 7.7 ose synon ta mbajë zonën e zbulimit në përputhje me nenin 7.8.

7.6 Në qoftë se Kontraktori njofton AKH-në për deklarimin e një zbulimi komercial, një deklaram i tillë do të bëhet mbi bazën që zbulimi mund të prodhojë komercialisht, pasi të merren në konsideratë të gjitha të dhënat operationale, teknike dhe financiare të mbledhura gjatë kryerjes së programit të vlerësimit dhe, nga ana tjetër, duke përfshirë, por pa u kufizuar në rezervat e rikuperueshme të naftës bruto dhe/ose të gazit natyror, nivelet e qëndrueshme të prodhimit dhe faktorë të tjerë teknikë dhe ekonomikë të rëndësishëm, në përputhje me praktikat e pranueshme ndërkombëtare të industrisë së naftës.

7.7 Nëse me kryerjen e programit të vlerësimit, Kontraktori konsideron që gazi natyror mund të prodhohet ekonomikisht, Kontraktori mund të hyjë në një fazë studimi teknik dhe të marketimit për të vlerësuar sa e arritshme nga ana teknike dhe komerciale është zhvillimi i zbulimit. Kontraktori do të kryejë punë përgatitore për një plan zhvillimi dhe një studim të gjithanshëm të tregut. Brenda dy (2) viteve nga data e dorëzimit të vendimit të Kontraktorit për të hyrë në një fazë studimi teknik dhe të marketimit, në përputhje me nenin 7.5 ose nenin 7.8, Kontraktori do të deklarojë një zbulim komercial ose do ta mbajë zonën e zbulimit në përputhje me nenin 7.8.

7.8 Nëse me kompletimin e programit të vlerësimit Kontraktori konsideron që një zbulim nuk është ekonomik për t'u zhvilluar, atëherë Palët do të takohen e do të diskutojnë dhe, nëse është e mundur, do bien dakord për të tilla amendamente të kontratës, të cilat do të lejojnë Kontraktorin të deklarojë një zbulim komercial.

Në rast se Palët nuk mund të arrijnë një marrëveshje të përbashkët, Kontraktori, pa paragjykuar klauzolat e dorëheqjes, sipas nenit 4, në lidhje me pjesën tjetër të zonës së kontratës mund të mbajë zonën e zbulimit dhe, në çdo kohë gjatë periudhës së mbajtjes, të rivlerësojë komercialitetin e një zhvillimi dhe të deklarojë një zbulim komercial ose në përputhje me nenin 7.7 të deklarojë që do të hyjë në fazën e studimit teknik dhe të marketimit. AKH-ja dhe Kontraktori së bashku do të bëjnë çdo përpjekje që, bazuar në një zbulim, ta bëjnë projektin komercialisht të zbatueshëm.

Periudha e mbajtjes së një zone zbulimi do të jetë tre (3) vjet për naftën brut dhe pesë (5) vjet për gazin natyror ose naftën brut me gaz shoqërues. Në rastin e gazit natyror ose naftës brut me gaz shoqërues kjo periudhë mbajtje mund të zgjatet deri në pesë (5) vjet, duke pasur parasysh që Kontraktori ka bërë përpjekjet më të mira për identifikimin e zgjidhjeve të mundshme dhe ekonomikisht tërheqëse në lidhje me çështjen. AKH-ja nuk do ta refuzojë në mënyrë të paarsyeshme miratimin e kësaj zgjatje.

7.9 Gjatë periudhës së mbajtjes, Kontraktori do të investigojë dhe do të vlerësojë alternativat e ndryshme për zhvillimin dhe shfrytëzimin komercial të atij zbulimi. Në rast se Kontraktori ka hequr dorë nga zona e zbulimit në përputhje me nenin 4, Kontraktori do të ketë të drejtën e refuzimit të parë në lidhje me ofrimin nga AKH-ja të zonës së zbulimit një pale të tretë. E drejta e refuzimit të parë do të jetë në fuqi për një periudhë prej pesë (5) vitesh nga data e dorëheqjes, pavarësisht nëse kjo PSA ka përfunduar ose jo, çka është në linjë me kohëzgjatjen e vlefshmërisë së marrëveshjes së konfidencialitetit sipas nenit 28 dhe do të zbatohet si më poshtë:

Nëse AKH-ja merr një ose më shumë oferta për një zonë që përfshin një pjesë ose të gjithë zonën e zbulimit dhe AKH-ja në mirëbesim dëshiron t'ia japë këtë zonë ofertuesit më të mirë, atëherë AKH-ja do të njoftojë kompanitë për termat e kësaj oferte. Kompanitë do të kenë gjashtëdhjetë (60) ditë kohë nga marrja e njoftimit për t'i pranuar këto terma.

Me pranimin e propozimit, secila prej kompanive dhe filialeve të tyre do të kenë të drejtë për një interes pjesëmarrje deri në pesëdhjetë (50) për qind të interesave të tyre pjesëmarrëse sipas kësaj Kontrate. AKH-ja, ofertuesi më i mirë dhe kompanitë ose filialet e tyre, të cilat ushtruan të drejtën e refuzimit të parë, do të negociojnë në mirëbesim termat dhe kushtet shtesë, të cilat zakonisht përmbahen në një marrëveshje me ndarje prodhimi. Për mënjanimin e çdo dyshimi, termat “kompani” dhe “interesa pjesëmarrje” do të kenë të njëjtin kuptim edhe me përfundimin e kësaj kontrate.

7.10 Në rast se AKH-ja vendos të zhvillojë një zonë zbulimi nga ku Kontraktori ka hequr dorë në përputhje me nenin 4, AKH-ja përpara fillimit të zhvillimit do t'i ofrojë kompanive një marrëveshje me ndarje prodhimi në lidhje me atë zonë zbulimi. AKH-ja dhe kompanitë ose filialet e tyre do të negociojnë në mirëbesim të tilla terma dhe kushte që zakonisht përmbahen në një marrëveshje me ndarje prodhimi.

## Neni 8

### **Zhvillimi dhe prodhimi**

8.1 Nëse Kontraktori raporton që një zbulim është zbulim komercial sipas nenit 7.5, nenit 7.7 ose nenit 7.8, Kontraktori do të përgatisë një plan zhvillimi dhe do ta dorëzojë në AKH për miratim sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se dymbëdhjetë (12) muaj nga data në të cilën AKH-së i është dorëzuar një raport në përputhje me nenin 7.5 ose nga deklarimi i një zbulimi komercial në përputhje me nenin 7.7 ose 7.8 sipas rastit. Kjo periudhë mund të zgjatet me kërkesë të Kontraktorit, nëse ekzistojnë rrethana të tilla që, në opinionin e arsyeshëm të palëve, justifikojnë këtë zgjatje.

Nëse plani i zhvillimit është në përputhje me qëllimin e marrëveshjes sipas nenit 2, AKH-ja do ta miratojë këtë plan zhvillimi brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve nga marrja e tij. Megjithatë, nëse AKH-ja dëshiron të propozojë ndryshime të ndonjë çështje specifike të planit të zhvillimit, brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e tij, AKH-ja do të njoftojë Kontraktorin, duke specifikuar në detaje të mjaftueshme arsyen e saj për një gjë të tillë.

Kontraktori do t'i kushtojë kujdes propozimit të AKH-së. Planin e zhvillimit i ndryshuar do të miratohet nga AKH-ja brenda tridhjetë (30) ditëve nga marrja e tij.

8.2 Planin e zhvillimit do të përgatitet mbi bazën e parimeve ekonomike dhe inxhinierike, në përputhje me praktikën përgjithësisht të pranueshme të industrisë ndërkombëtare të naftës dhe mund të rishikohet kohë mbas kohe. Ndryshimet do të miratohen në përputhje me nenin 8. 1.

8.3 Planin e zhvillimit do të përmbajë:

8.3.1 detajet e shtrirjes të zonës së zhvillimit dhe prodhimit që lidhet me zbulimin komercial, zonë e cila do t'i korrespondojë zgjerimit gjeografik të zbulimit komercial, plus një kufi

të arsyeshëm, dhe do të përcaktohet si zona e zhvillimit dhe e prodhimit për këtë zbulim komercial;

8.3.2 propozimet lidhur me hapësirën, shpimin dhe kompletimin e puseve, instalimet e prodhimit dhe magazinimit dhe pajisjet e transportimit dhe të shpërndarjes që kërkohen për prodhimin, magazinimin dhe transportimin e hidrokarbureve.;

8.3.3 propozime në lidhje me investimet e nevojshme për infrastrukturë;

8.3.4 një parashikim për prodhimin dhe një vlerësim të investimeve dhe të shpenzimeve të nevojshme;

8.3.5 një vlerësim të kohës së kërkuar për të kryer çdo fazë të planit të zhvillimit; dhe

8.3.6 pikën e livrimit dhe pikën e matjes të propozuara; dhe

8.3.7 në rastin e një zbulimi të gazit natyror, një studim të gjithanshëm të tregut, duke përfshirë termat e një marrëveshjeje shitje gazi me blerës potencialë, formulën e shitjes së gazit dhe metodën e pagesës.

8.4 AKH-ja mund t'i kërkojë Kontraktorit informacion të mëtjshëm, që mund të jetë i gatshëm dhe që AKH-së mund t'i nevojitet në mënyrë të arsyeshme për të vlerësuar planin e zhvillimit për ndonjë zonë zhvillimi dhe prodhimi. Një kërkesë e tillë për informacion duhet të bëhet brenda tridhjetë (30) ditësh pas marrjes së planit të zhvillimit dhe Kontraktori do të bëjë përpjekje të arsyeshme të përgjigjet brenda tridhjetë (30) ditësh.

8.5 Në qoftë se AKH-ja nuk kërkon me shkrim ndonjë ndryshim në planin e zhvillimit, brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas marrjes së tij, plani do të konsiderohet i miratuar nga AKH-ja.

8.6 Në qoftë se AKH-ja kërkon ndonjë ndryshim në planin e zhvillimit atëherë Kontraktori dhe AKH do të takohen brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas marrjes nga Kontraktori të njoftimit të shkruar të AKH-së, për të arritur një marrëveshje në lidhje me ndryshimet e kërkuara në planin e zhvillimit.

8.7 Pasi është aprovuar plani i zhvillimit, Kontraktori do të paraqesë në Komitetin Këshillimor, gjashtëdhjetë (60) ditë para mbarimit të çdo viti kalendarik, një raport të detajuar të programit të punës së zhvillimit dhe buxhetin për vitin kalendarik pasardhës. Për vitin e parë kalendarik të plotë dhe pjesën e vitit kalendarik që është përpara vitit të parë të plotë kalendarik, një raport i detajuar i programit të punës së zhvillimit dhe buxheti do të paraqiten brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh pas datës së aprovimit të planit të zhvillimit në përputhje me nenin 8.1, 8.5 ose 8.6. Çdo raport vjetor i tillë i detajuar i programit të punës së zhvillimit dhe buxhetit duhet të jetë konsistent me planin e zhvillimit të aprovuar në përputhje me nenin 8.1, 8.5 ose siç mund të jetë rishikuar në përputhje me nenin 8.1, 8.6 dhe 8.8.

8.8 Kontraktori, në çdo kohë, mund t'i paraqesë AKH-së ose Komitetit Këshillimor, sipas rastit, rishikimin e ndonjë plani zhvillimi ose programit të punës të zhvillimit dhe buxhetit. Këto rishikime do të jenë konsistentë me klauzolat e nenit 8.2 dhe, në rastin e rishikimit të planit të zhvillimit, do të jetë subjekt i procedurës së aprovimit siç parashikohet në nenin 8.1, 8.2, 8.5 dhe 8.6 dhe, në rastin e programit të punës të zhvillimit dhe buxhetit, subjekt i rishikimit sipas neni 5.1.5.3.

8.9 Kur AKH-ja dhe Kontraktori bien dakord që një përfitim ekonomik reciprok mund të arrihet duke ndërtuar dhe operuar infrastrukturë të përbashkët (duke përfshirë, por pa u kufizuar, rrugët, tubacionet dhe pajisje të tjera të transportimit, komunikimit, përpunimin fushor dhe magazinimit), Kontraktori do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të arritur një marrëveshje me prodhuesit e tjerë dhe AKH-në për ndërtimin dhe operimin e infrastrukturës së tillë të përbashkët, rikuperimin e investimeve dhe tarifat për t'u paguar.

8.10 Në qoftë se, si rrjedhim i përcaktimit të zonës së zhvillimit dhe prodhimit, shtrirja e zonës që përfshin zbulimin komercial në mënyrë të arsyeshme pritet të jetë më e madhe sesa përcaktimi në planin e zhvillimit në përputhje me nenin 8.3, zona e zhvillimit dhe prodhimit, me kërkesën e Kontraktorit do të zgjerohet pa kosto të Kontraktorit, duke pasur parasysh që në zonën që mbulohet nuk është lidhur ndonjë kontratë ose licencë për kërkimin ose prodhimin e hidrokarbureve.

8.11 Në qoftë se sipas opinionit të Kontraktorit një zbulim komercial më pas konstatohet që nuk është më komercial, por Kontraktori megjithatë shikon mundësi teknike për të zhvilluar komercialisht zbulimin, Palët do të takohen dhe do të diskutojnë dhe, në qoftë se është e mundur, do të bien dakord në një amendament të tillë të kontratës, i cili e lejon Kontraktorin ta zhvillojë

zbulimin komercial. Nëse Palët nuk arrijnë ndonjë marrëveshje të përbashkët, atëherë neni 7.8 do të aplikohet *mutatis mutandis*.

## Neni 9

### Pjesa e Qeverisë, rikuperimi i kostove, kostot e parikuperueshme

9.1 Kontraktori do të sigurojë të gjitha fondet që kërkohen për të kryer operacionet hidrokarbure në përputhje me këtë kontratë dhe mund t'i rikuperojë kostot dhe shpenzimet e tij nga hidrokarburet kosto në mënyrën dhe në shtrirjen që lejohet sipas neni 9.4. Kontraktori do të ketë të drejtë të përdorë pa pagesë hidrokarburet e prodhuara nga zona e kontratës në masën që e konsideron të nevojshme për operacionet hidrokarbure sipas kësaj kontrate.

9.2 Hidrokarburet e disponueshme do të maten në pikën e matjes dhe do të ndahen siç përcaktohet në këtë kontratë.

9.3 Një përqindje e hidrokarbureve të disponueshme (këtu më poshtë e përcaktuar si "Granti për Qeverinë") do t'i jepet AKH-së sipas një shkallëzimi, bazuar në faktorin R, siç do të përcaktohet më poshtë, në përputhje me skemën e mëposhtme:

Faktori R	Granti për Qeverinë	
	Nafta brut	Gazi natyror
$0.0 < R \leq 1.5$	8%	0%
$1.5 < R \leq 2.0$	11%	0%
$2.0 < R \leq 2.5$	13%	0%
$2.5 < R$	15%	0%

Është e kuptueshme që granti për Qeverinë nuk do të konsiderohet si kosto e mbulueshme dhe shpenzim dhe nuk do të zbritet nga taksa në mënyrë që të ndikojë në taksën shqiptare mbi fitimin e pagueshëm nga kompanitë.

Faktori R është përcaktuar si më poshtë:

$$RN = \frac{\sum_{i=1}^{N-2} \left( A_i \prod_{j=i+1}^{N-1} e_j \right) + A_{N-1}}{\sum_{K=1}^{N-2} \left( B_K \prod_{j=K+1}^{N-1} \right) + B_{N-1}}$$

ku:

N = është viti kalendarik për të cilin është llogaritur faktori R.

i = 1 viti i parë kalendarik kur janë marrë të ardhurat.

K = 1 viti i parë kalendarik kur janë kryer shpenzimet.

$A_i$  = të ardhurat e Kontraktorit = hidrokarburet kosto plus pjesën e Kontraktorit nga teprica e hidrokarbureve kosto minus taksën mbi fitimin të paguar për atë vit kalendarik.

$B_K$  = kostot operative hidrokarbure për atë vit kalendarik.

$e_j$  = koeficienti i inflacionit vjetor i shprehur në shifra dhjetore (i rrumbullakosur me tre shifra pas presjes dhjetore, p.sh. 0.043), bazuar në "Indeksi i çmimit të konsumatorit për të gjithë konsumatorët urbanë" (All Items, 1982-84 = 100), i publikuar çdo muaj nga US Department of Labor, Bureau of Labor Statistics në "Monthly Labour Review". Koeficienti i inflacionit vjetor do të llogaritet duke përdorur indeksin e dhjetorit për vitin kalendarik përkatës.

$\Sigma$  do të thotë "shuma".

$\Pi$  do të thotë "shumëzim".

Faktori R i aplikuar për vitin kalendarik paraardhës, do të aplikohet për vitin kalendarik prezent për aq kohë sa indeksi i çmimit të konsumatorit (*consumer price index*) nuk ka qenë i publikuar. Sapo shifra e re për indeksin e çmimit të konsumatorit për vitin kalendarik paraardhës të

publikohet, faktori R (dhe të drejtat e grantit për Qeverinë, hidrokarburet kosto dhe hidrokarburet kosto tepricë) do të rillogariten që nga 1 janari i vitit kalendarik prezent bazuar në këtë shifër të re për indeksin e çmimit të konsumatorit.

Ndonjë rillogaritje e të drejtave për vitin kalendarik prezent do të shtrihet mbi pjesën e mbetur të vitit kalendarik prezent, në një mënyrë që pala që ka të drejtën e një sasi shtesë hidrokarburesh për vitin kalendarik prezent, do ta marrë sasinë e rillogaritur në sasi mujore të barabarta në shtesë të pjesës së saj të rregullt. Në qoftë se prodhimi në ndonjë muaj është i pamjaftueshëm për të plotësuar sasinë e rillogaritur, atëherë pjesa e paplotësuar do të mbartet përpara dhe do të shpërndahet në mënyrë të barabartë në muajt e mbetur të vitit kalendarik prezent.

Përcaktimi i faktorit R do të bëhet së pari për vitin kalendarik që nga data efektive deri në fund të atij viti kalendarik.

Në rast se indeksi i sipërpërmendur nuk do të publikohet me ose metodologjia për llogaritjen e indekseve do të ndryshojë në mënyrë të dukshme, AKH-ja dhe Kontraktori do të bien dakord për një metodë të arsyeshme dhe të besueshme të indeksimit për qëllimin e përcaktimit të faktorit R. Në rast se publikimi i indeksit vonohet, AKH-ja dhe Kontraktori do të bien dakord për një procedurë të arsyeshme dhe të drejta për të siguruar që Kontraktori nuk do të ketë pasoja ekonomike nga një vonesë e tillë.

Në të njëjtën kohë me aprovimin e planit të zhvillimit, AKH-ja dhe Kontraktori do të bien dakord nëse granti për Qeverinë do të merret në naftë nga AKH-ja ose do të merret dhe shitet nga Kontraktori në emër të Qeverisë dhe, pasi të merren të ardhurat nga shitje të tilla, rrjedhimisht paguhet në *cash* (me para në dorë) AKH-së, bazuar në vlerësimin e naftës bruto sipas nenit 13. Në rast se Palët bien dakort që granti për Qeverinë do të merret si naftë nga AKH-ja, kjo marrëveshje do të përmbajë parashikime të ndërsjella në lidhje me ndarjen e sasive të ndryshme të hidrokarbureve dhe procedurat e marrjes së tyre, duke përfshirë edhe marrjet me tepricë ose me mangësi të pjesës së AKH-së.

9.4 Kontraktori do të mbulojë të gjitha kostot e operacioneve hidrokarbure nga zona e kontratës në masën dhe deri në maksimum një qind për qind (100%) nga të gjitha hidrokarburet e disponueshme pasi të ketë zbritur grantin për Qeverinë.

9.5 Kostot e operacioneve, duke përfshirë të gjitha ato kosto të akumuluar para fillimit të prodhimit komercial, do të rikuperohen plotësisht, pa amortizim, duke filluar (i) në tremujorin në të cilin këto kosto janë kryer ose (ii) duke ndjekur fillimin e prodhimit komercial, cilido që të ndodhë më vonë.

9.6 Në masën që, në një tremujor të dhënë, pjesa e kostove të operacioneve hidrokarbure të rikuperueshme sipas nenit 9.4 e kalojnë vlerën e hidrokarbureve kosto për atë tremujor, teprica do të mbartet përpara për rikuperim në tremujorin pasardhës dhe në çdo tremujor pasardhës deri sa të rikuperohet plotësisht.

9.7 Klauzolat e vlerësimit të hidrokarbureve të nenit 13 do të përdoren për përcaktimin e vlerës dhe të sasisë së hidrokarbureve kosto për të cilën Kontraktori titullohet këtu më poshtë.

9.8 Kostot dhe shpenzimet e mëposhtme nuk do të jenë të rikuperueshme sipas kësaj kontrate.

9.8.1 Kostot e kryera para datës efektive dhe të lidhura me kryrjen e punës minimale të detyrueshme, në qoftë se nuk janë aprovuar nga AKH-ja; dhe

9.8.2 kostot e kryera pas pikës së lëvrimit ; dhe

9.8.3 donacionet dhe kontributet, në qoftë se nuk janë aprovuar nga AKH-ja; dhe

9.8.4 ndonjë bonusi paguar AKH-së në përputhje me nenin 12; dhe

9.8.5 gjobat ose penalitetet të ngarkuara nga një agjenci e Qeverisë së Shqipërisë dhe paguar nga Kontraktori.

9.8.6 shpenzimet e interesit.



Neni 10  
**Ndarja e prodhimit**

10.1 Hidrokarburet e disponueshme që nuk merren si grant për Qeverinë dhe hidrokarburet kosto siç përshkruhet në nenin 9 (hidrokarburet kosto teprice) do të ndahen ndërmjet AKH-së dhe Kontraktorit. Një ndarje e tillë do të bëhet mbi bazë të faktorit R dhe do të llogariten për çdo vit kalendarik në proporcionet e mëposhtme:

Faktori R	Nafta brut		Gazi natyror	
	AKH Kontraktori		AKH Kontraktori	
$0.0 < R \leq 1.5$	0%	100%	0%	100%
$1.5 < R \leq 2.0$	5%	95%	0%	100%
$2.0 < R \leq 2.5$	10%	90%	0%	100%
$R > 2.5$	15%	85%	0%	100%

Llogaritja e faktori R do të bëhet në përputhje me nenin 9.

10.2 Është e kuptueshme që termi fitim, në përputhje me nenin 18.1, dhe hidrokarburet kosto teprice janë përherë të barabarta, pavarësisht nëse ato shprehen në barrela ose respektivisht në metër kub standard ose në dollarë amerikanë.

10.3 Hidrokarburet e prodhuara gjatë testimit të prodhimit do të jenë të disponueshme për Kontraktorin në kokën e pusit, pa pagesë. Çdo sasi e gazit natyror që nuk merret nga Kontraktori mund të digjet në fakel.

10.4 Çdo sasi e gazit natyror e prodhuar nga zona e kontratës, në atë masë që nuk është përdorur në operacionet hidrokarbure, mund të digjet nëse përpunimi ose përdorimi i këtij gazi natyror nuk është ekonomik dhe as nuk është ekonomikisht, teknikisht apo komercialisht i përshtatshëm për t'u riinjektuar. Kjo djegie në fakel mund të lejohet në atë masë përderisa kjo sasi gazi nuk nevojitet për të ndikuar në nxjerrjen ekonomike të naftës brut nëpërmjet operacioneve të metodave dytësore, duke përfshirë rritjen e presionit apo riqarkullimin.

10.5 Në rast se Kontraktori e konsideron që përpunimi dhe përdorimi i gazit natyror nuk është ekonomik, atëherë AKH-ja mundet, duke pasur parasysh që këto veprime nuk do të ndikojnë në operacionet hidrokarbure, të zgjedhë ta marrë e ta përdorë këtë gaz natyror, pa pagesë, për aq kohë sa ai përndryshe do të digjej në fakel; gjitha kostot e marrjes dhe transportit do të jenë për llogari dhe risk të vetë AKH-së.

10.6 Kontraktori do të marrë në pikën e lëvrimit dhe mundet që t'i disponojë veçmas hidrokarburet ndaj të cilave ai ka të drejta në përputhje me këtë nen dhe nenin 9. Të drejtat dhe risku për humbjet do të kalojnë te Kontraktori në pikën e lëvrimit. Kontraktori do të ketë të drejtë që lirisht të eksportojë gjitha hidrokarburet për të cilat atij i është dhënë e drejta.

Në të njëjtën kohë me miratimin e planit të zhvillimit, AKH-ja dhe Kontraktori do të bien dakort nëse ndarja e hidrokarbureve kosto teprice do të merret në naftë nga AKH-ja apo do të merret e do të shitet nga Kontraktori në emër të AKH-së dhe për pasojë, mbasi të ketë marrë të ardhurat nga kjo shitje, të paguajë në *cash* (me para në dorë) AKH-në në bazë të vlerësimeve sipas nenit 13. Në rast se Palët bien dakort që pjesa e AKH-së e hidrokarbureve kosto teprice do të merret nga AKH-ja si naftë, kjo marrëveshje do të përmbajë parashikime të ndërsjella në lidhje me ndarjen e sasive të ndryshme të hidrokarbureve dhe procedurat e marrjes duke përfshirë edhe marrjen me teprice ose mangësi të pjesës së AKH-së.

Neni 11

Ky nen është lënë qëllimisht bosh.

## Neni 12 Bonuset

12.1 Kontraktori, brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas datës në të cilën AKH-ja njofton Kontraktorin për aprovimin e kontratës nga Këshilli i Ministrave, do të paguajë si një bonus nënshkrimi shumë prej katërqind mijë dollarë amerikanë (400 000 US\$). Në mënyrë alternative, AKH-ja do të ketë opsionin të marrë materiale me vlerë korresponduese. Kontraktori dhe AKH-ja do të bien dakord me specifikimin, sasinë dhe vlerën e këtyre materialeve.

12.2 Kontraktori do t'i paguajë AKH-së një bonus prodhimi prej tetëqind mijë dollarë amerikanë (US\$ 800 000.00) brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve pas datës së parë kur prodhimi mesatar ditor :

i) i naftës brut të prodhuar nga zona e kontratës për një periudhë tridhjetë (30) ditë e njëpasnjëshme arrin në njëzet e pesë mijë (25 000) barela naftë në ditë, ose;

ii) i gazit natyror prej zonës së kontratës për një periudhë tridhjetë (30) ditë të njëpasnjëshme arrin në njëqind e pesëdhjetë (150) milionë metër kub standard në ditë dhe një bonus tjetër prodhimi prej prej tetëqind mijë dollarë amerikanë (US\$ 800 000.00) nën të njëjtat kushte si më sipër kur:

i) prodhimi i naftës bruto të arrijë në pesëdhjetë mijë (50 000) barela në ditë, ose

ii) prodhimi i gazit natyror arrin në treqind (300) milionë metër kub standard në ditë.

## Neni 13 Vlerësimi i hidrokarbureve

13.1 Termat e përdorur në këtë nen, do të kenë kuptimin e mëposhtëm:

13.1.1 “Naftë bruto reference” do të thotë nafta(t) bruto me gravitet dhe cilësi të krahasueshme me naftën bruto të vlerësuar. Nafta(t) bruto që përbëjnë naftën bruto reference do të përzgjidhen dhe do të bihet dakord nga AKH-ja dhe Kontraktori përpara fillimit të prodhimit komercial nga ndonjë zonë zhvillimi dhe prodhimi ose, në qoftë se dështojnë në arritjen e marrëveshjes, përcaktohet nga një ekspert.

13.1.2 “Çmimi i naftës bruto reference” do të thotë mesatarja FOB pika e eksportit ose CIF, siç mund të jetë rasti, çmimi spot për naftën bruto reference gjatë periudhës së kohës së duhur, siç kuotohet në "Platt's Oilgram Price Report" ose publikime të tjera të tilla siç mund të bien dakord midis AKH-së dhe Kontraktorit, të korrigjuara, siç mund të jetë e nevojshme për të reflektuar termat e pagesës tridhjetë (30) ditore dhe diferencën në gravitet, cilësi dhe vendndodhje ndërmjet naftës bruto reference dhe naftës bruto që vlerësohet këtu.

13.1.3 “Kosto transportimi” do të thotë (i) kostoja e transportimit e përcaktuar me referencë tek “Average Freight Rate Assessment” (AFRA) e publikuar së fundmi nga “London Tanker Broker Association” ose publikime të tjera të “Freight Rate” të naftës bruto, siç mund të bien dakord AKH-ja dhe Kontraktori ose siç përcaktohet nga “London Tanker Brokers Panel”, i aplikueshëm për lundrimet ndërmjet pikave të specifikuara, duke përdorur anije të përmasave të përshtatshme dhe (ii) pagesat e tarifës për dërgimin naftës bruto nga Kontraktori nëpërmjet tubacioneve të zotëruara nga një palë e tretë në Shqipëri.

13.2 Për qëllim të përcaktimit të vlerës së naftës bruto sipas kësaj kontrate, një vlerë në dollarë amerikanë për barelë naftë bruto do të përcaktohet çdo tremujor. Kjo vlerë do të jetë vlera (*Fair Market Value*) e përcaktuar në përputhje me nenin 13.3.

Vlera e gazit natyror të marrë nga kompanitë sipas kësaj kontrate gjatë çdo tremujori për të gjitha qëllimet e kësaj kontrate do të jetë çmimi mesatar i ponderuar i marrë në monedhë lehtësisht të konvertueshme në pikën e lëvrimit.

13.3 *Fair Market Value* (çmimi i arsyeshëm i tregut) do të jetë çmimi i referencës së naftës brut i aplikueshëm për naftën bruto të shitur nga kontraktori gjatë tremujorit të dhënë, i përshtatur në bazë të një pike eksporti duke shtuar kostot e transportimit për naftën bruto reference nga pika e tij e eksportit për në tregun në të cilin naftë bruto reference do të shitej normalisht dhe duke hequr kostot e transportimit nga pika e lëvrimit për në tregun në të cilin nafta bruto do të shitej normalisht.

Në asnjë rast, nga çmimi i naftës bruto reference, nuk do të zbritet ndonjë komision ose tarifë marketingu.

13.4 Brenda njëzet (20) ditësh pas fundit të çdo tremujori, Kontraktori do të përcaktojë vlerën e hidrokarbureve në përputhje me këtë nen 13 dhe do të njoftojë AKH-në. Në rast se AKH-ja nuk e njofton Kontraktorin brenda njëzet (20) ditësh pas marrjes së një njoftimi të tillë se ajo nuk bie dakort me përcaktimin e Kontraktorit dhe nuk specifikon në atë njoftim arsyet për këtë mospranim, përcaktimi i Kontraktorit mbi vlerën e hidrokarbureve do të konsiderohet për pasojë i aprovuar.

13.5 Në rastin kur AKH-ja ka njoftuar në kohë Kontraktorin, brenda periudhës njëzetditore të sipërpërmendur, që ajo nuk bie dakord me përcaktimin e Kontraktorit për vlerën e hidrokarbureve, AKH-ja dhe Kontraktori do të takohen të diskutojnë përcaktimin e Kontraktorit. Në qoftë se AKH-ja dhe Kontraktori dështojnë në arritjen e një marrëveshje për vlerën e hidrokarbureve brenda shtatëdhjetë e pesë (75) ditësh pas përfundimit të tremujorit në diskutim, secila nga Palët mund t'ia paraqesë përcaktimin e vlerës (dhe zgjedhjen e naftës bruto që përbën naftën bruto reference, në qoftë se nuk është rënë dakord më parë) një eksperti në përputhje me nenin 24.10.

13.6 Ndarja e hidrokarbureve për grantin për Qeverinë dhe hidrokarburet kosto teprice në një vit kalendarik përcaktohet nëpërmjet faktorit R siç përcaktohet në nenin 9.3. Të ardhurat në numëruesin e formulës së faktorit R do të bazohen në shumën për vit kalendarik të vlerës së naftës bruto të përcaktuar për çdo tremujor ose në rastin e një mosmarrëveshje në përputhje me nenin 13.5, vlera e përcaktuar nga Kontraktori do të aplikohet specifikisht në lidhje me të.

Ndarja e hidrokarbureve do të bazohet në vlerën e hidrokarbureve të përcaktuara për çdo tremujor, ose në rastin e një mosmarrëveshjeje në përputhje me nenin 13.5, vlera e përcaktuar nga Kontraktori do të aplikohet në lidhje me të.

Kur përcaktohet një vlerë e re e hidrokarbureve, kjo vlerë e re e hidrokarbureve do të aplikohet në mënyrë prapavepruese për tremujorin të cilit i korrespondon përcaktimi i diskutueshëm dhe korrigjimet e nevojshme do të bëhen në pjesët e Palëve, në mënyrë që të reflektojnë veprimin prapaveprues të vlerës së re të hidrokarbureve.

## Neni 14 Unitizimi

14.1 Në qoftë se në ndonjë kohë në të cilën kjo kontratë është në fuqi, shtresa hidrokarburmbajtëse në zonën e kontratës shtrihet në një zonë ose në zona të tjera, në lidhje me të cilat është në fuqi një licencë ose kontratë dhënë nga AKH-ja, Kontraktori do të marrë përsipër të bashkëpunojë me mbajtësit e licencës në bllokun pranë tij, me qëllimin që të arrijë zgjidhjen optimale teknike dhe ekonomike për zhvillimin e të gjithë vendburimit. Në qoftë se Kontraktori dhe mbajtësi i licencës në blloqet respektive fqinje nuk mund të bien dakord për një plan zhvillimi të përbashkët ose për caktimin e operatorit, ose në qoftë se AKH-ja konsideron që plani i zhvillimit i propozuar nuk është në interesin kombëtar, atëherë AKH-ja mund të përcaktojë që të gjitha operacionet të kryhen në përputhje me një skemë zhvillimi të unitizuar.

14.2 Skema e zhvillimi të unitizuar do të miratohet nga Kontraktori dhe Pala e tretë që ka kontratën ose licencën e dhënë nga AKH-ja, të cilët do të paraqesin së bashku skemën për aprovim nga AKH-ja. Dështimi në arritjen e një marrëveshje për një skemë zhvillimi të unitizuar midis Kontraktorit dhe Palës së tretë, ose dështimi i AKH-së për të bërë aprovimin, do të çojë në atë që skema e zhvillimit të unitizuar të përgatitet nga një ekspert. Në qoftë se Kontraktori e gjen skemën e përgatitur nga eksperti të papranueshme, Kontraktori mund të zgjedhë që ta shesë ose të heqë dorë nga vendburimi.

14.3 Kontraktori do të zbatojë dhe respektojë të gjithë termat dhe kushtet e një skeme zhvillimi të unitizuar të përcaktuar sipas nenit 14.2.

14.4 Në qoftë se në ndonjë kohë gjatë së cilës kontrata është në fuqi, shtresa hidrokarburmbajtëse në zonën e kontratës, që formon pjesë të një zbulimi të vetëm, shtrihet në një zonë e cila ndodhet nën juridiksionin e Qeverisë së Shqipërisë dhe në lidhje me të cilën asnjë kontratë ose licencë nuk ka hyrë ose është në fuqi, AKH-ja dhe Kontraktori do të hyjnë në një marrëveshje për ta zgjeruar zonën e kontratës sipas termave të kësaj kontrate dhe të sigurojnë një

zhvillim të përshtatshëm të zbulimit. Si pjesë e një marrëveshjeje të tillë, Kontraktori mund të lejohet të shikojë ndonjë të dhënë gjeologjike dhe gjeofizike, të cilat janë në zotërim të AKH-së ose do të lejohet të kryejë një program vlerësimi shtesë në zonën e interesuar, siç mund t'i kërkohej të përcaktojë zonën e zgjerimit.

14.5 Në rastin kur shtresa hidrokarburmbajtëse referuar në nenin 14.1 shtrihet në një zonë që nuk formon pjesë të zonës së kontratës dhe mbi të cilën Republika e Shqipërisë nuk ka juridiksion, operacionet hidrokarbure të Kontraktorit do të kryhen në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë, siç mund të jenë të aplikueshme dhe AKH-ja do të marrë përsipër të negociojë me agjencinë kompetente të qeverisë së huaj që ka në juridiksion zonën, për të rënë dakord për një skemë zhvillimi të unitizuar, duke pasur në mend interesat e Kontraktorit. Kontraktori do t'i sigurojë AKH-së asistencë eksperti për të arritur qëllimin. Kjo kontratë do të amendohet për të reflektuar marrëveshjen e arritur midis dy vendeve. Në qoftë se një amendament i tillë është i papranueshëm nga Kontraktori, atëherë Kontraktori do të ketë të drejtë të kërkojë modifikime ose të heqë dorë nga zona e zbulimit në të cilën ndodhet shtresa hidrokarburmbajtëse.

14.6 Koha që kërkohej për të negociuar dhe përcaktuar skemën e zhvillimit të unitizuar do t'i shtohet respektivisht periudhës së përcaktuar në nenin 8.1.

## Neni 15

### **Punësimi dhe trajnimi (kualifikimi)**

15.1 Në kryerjen e operacioneve hidrokarbure, Kontraktori do të zgjedhë punonjësit e tij dhe përcaktojë numrin e tyre. Kontraktori do të marrë përsipër të punësojë një numër të arsyeshëm punonjësish shqiptarë në qoftë se aftësitë profesionale, njohuritë dhe eksperiencat përputhen me kërkesat operacionale. Në të kundërt, Kontraktori do të jetë i lirë të punësojë profesionistë të huaj të tillë që të plotësojnë nevojat e tij.

15.2 Kontraktori do të shpenzojë një minimum prej tridhjetë e pesë mijë dollarë amerikanë (US\$ 35 000.00) si fonde trajnimi (kualifikimi) gjatë çdo viti kalendarik të periudhës së kërkimit.

Fondet e trajnimit (kualifikimit) do të perdoren për:

15.2.1 blerjen nga AKH-ja të literaturës teknike të avancuar, të dhëna dhe instrumente shkencore;

15.2.2 dërgimin e punonjësve shqiptarë të kualifikuar në kurse të zgjedhura në fushën e shkencës, inxhinierisë dhe menaxhimit të naftës, sipas kërkesës së AKH-së; dhe

15.2.3 mbulimin nga AKH-ja të disa shpenzimeve administrative të lidhura me këtë nen 15.2.

15.3 Shpenzimet e shumave për qëllimet e specifikuar më sipër, do të bëhen në përputhje me programet e detajuara të trajnimit (kualifikimit) vjetor, të cilat do të përgatiten dhe do të bien dakord së bashku nga AKH-ja dhe Kontraktori.

15.4 Të gjitha shpenzimet e bëra në përputhje me këtë nen 15, në lidhje me trajnimin (kualifikimin) dhe arsimimin, do të jenë plotësisht të rikuperueshme nga hidrokarburet kosto në përputhje me nenin 9.

15.5 Në rast se Kontraktori nuk ka shpenzuar tridhjetë e pesë mijë dollarë amerikanë (US\$ 35 000.00), në përputhje me nenin 15.2, deri në fund të vitit kontraktor, Kontraktori me kërkesë të AKH-së do ta transferojë sasinë e mbetur në llogarinë bankare të AKH-së.

## Neni 16

### **E drejta e pronësisë**

16.1 Pasuritë fizike të Kontraktorit, të cilat janë blerë ekskluzivisht për qëllim të operacioneve hidrokarbure, do të bëhen pronë e AKH-së sapo të ndërpritet ose përfundojë kjo kontratë ose të jenë rikuperuar kostot e këtyre pasurive fizike nga Kontraktori, cilado që të ndodhë e para. Pasuritë do të klasifikohen si kosto e rikuperueshme nga Kontraktori në përputhje me nenin 9, sapo të importohen ose blihen. Raportet dhe kampionet e marra ose të përgatitura nga Kontraktori për operacionet hidrokarbure do të bëhen pronë e AKH-së me mbarimin e kësaj kontrate ose me

rikuperimin e kostos, cilado që të ndodhë më parë dhe do të jenë kosto e rikuperueshme nga Kontraktori në përputhje me nenin 9, kur merren ose përgatiten.

Pavarësisht sa më sipër, Kontraktori do të ketë të drejtë t'i përdorë pa pagesë ato pasuri, raporte dhe kampionatura gjatë afatit të kësaj kontrate.

16.2 Klauzolat e nenit 16.1 nuk do të aplikohen për pasuritë e marra me qira nga Kontraktori ose filialet e tij, e as për pasuritë e zotëruara nga kontraktorët e Kontraktorit, nënkontraktorët, filialet ose palë të tjera.

16.3 Sipas Marrëveshjeve me Kontraktorin, kompanitë, nëse nuk kryejnë operacione hidrokarbure që parashikohen këtu, filialet e tyre dhe palët e treta mund t'i përdorin ato pasuri fizike në përputhje me nenin 16.1. Kontraktori mund të kërkojë kompensim i cili do të kreditohet në llogarinë e kostos. Pas përfundimit të kësaj kontrate, kompanitë dhe filialet e tyre do të kenë të drejtë të përdorin ndonjë kapacitet të lirë dhe do të kenë të drejta preferenciale për të operuar këto pasuri fizike sipas marrëveshjes me AKH-në për një kompensim me pagesë të arsyeshme.

## Neni 17

### **Të drejtat dhe detyrimet e Palëve**

17.1 Kontraktori do të ketë të drejtë hyrjeje dhe daljeje në zonën e kontratës dhe në zona ose ambiente të tjera, si të jetë e nevojshme, për operacionet hidrokarbure.

17.2 Kontraktori do të ketë të drejtë, gjatë afateve të përcaktuara këtu, të marrë lirisht, përpunojë, transportojë, disponojë dhe eksportojë pjesën e tij të hidrokarbureve dhe të mbajë jashtë shtetit të ardhurat e marra nga ajo.

17.3 Kontraktori do të sigurojë që të gjitha fondet e nevojshme dhe do të mbulojë të gjitha kostot dhe shpenzimet që kërkohen për kryerjen e operacioneve hidrokarbure sipas kësaj kontrate, përveç në masën kur mund të parashikohet ndryshe në këtë kontratë.

17.4 Kontraktori do të marrë përsipër të arrijë përdorimin eficient dhe të sigurt gjatë kërkimit dhe prodhimit të hidrokarbureve dhe optimizojë rikuperimin ekonomik përfundimtar të hidrokarbureve nga zona e kontratës.

17.5 Kontraktori do të sigurojë të gjitha materialet, pajisjet dhe infrastruktura e përdorur në operacionet hidrokarbure të jenë në përputhje me format inxhinierike përgjithësisht të pranuar, të kenë konstruksion të përshtatshëm dhe të jenë mbajtur në gjendje pune optimale.

17.6 Kontraktori do të blejë ose marrë me qira të gjitha pajisjet, materialet, shërbimet dhe furnizimet e kërkuara për t'u blerë ose për t'u marrë me qira, në përputhje me programet e punës.

17.7 Kontraktori do ta informojë AKH-në në vazhdimësi për të gjitha aktivitetet që do të kryhen sipas kësaj kontrate dhe do t'i japë AKH-së raporte tremujore për operacionet hidrokarbure të kryera.

17.8 Kontraktori do të bëjë të mundur për përfaqësuesit e AKH-së inspektimin, në çdo kohë të arsyeshme, të operacioneve hidrokarbure sipas kësaj kontrate, duke pasur parasysh që një inspektim i tillë nuk pengon në mënyrë të paarsyeshme operacionet hidrokarbure.

17.9 Kontraktori do të mbajë regjistrime origjinale të plota të të gjitha operacioneve hidrokarbure teknike sipas kësaj kontrate.

17.10 Kontraktori do të mbajë llogaritë e operacioneve hidrokarbure në përputhje me procedurën llogaritëse, në një mënyrë të tillë që të paraqesë një regjistrim të mirë, të qartë dhe të kujdesshëm të të gjitha kostove, shpenzimeve dhe detyrimeve të kryera për operacionet hidrokarbure.

17.11 Kontraktori, pas përfundimit të shpimit të një pusi, do të informojë AKH-në nëse dhe kur pusi do të provohet, dhe pas përfundimit të ndonjë prove(ave), nivelin(et) e prodhimit të përcaktuar(a).

17.12 Kontraktori do ta magazinon naftën bruto në mënyrë të përshtatshme në depozita të ndërtuara për këtë qëllim.

17.13 Kontraktori do të bëjë një sigurim të tillë siç bëhet normalisht në industrinë ndërkombëtare të naftës për llogarinë e kostos.

17.14 AKH-ja do ta asistojë dhe nxisë kryerjen nga Kontraktori të programit të punës, duke siguruar me kosto lehtësira dhe furnizime duke përfshirë, por pa u kufizuar në vënien në dispozicion të të gjitha vizave të nevojshme, lejeve të punës, lejeve të transportimit, mbrojtjen dhe të drejtat e kalimit dhe lehtësi të tjera siç mund të kërkohet nga Kontraktori dhe që bëhen të disponueshme nga burime brenda kontrollit të AKH-së. Në rastin kur lehtësi të tilla, furnizime ose personeli nuk janë lehtësisht të disponueshëm, atëherë AKH-ja do të sigurojë menjëherë përdorimin e lehtësive të tilla dhe furnizimeve nga burime të tjera alternative, në qoftë se ka. Shpenzimet e kryera në këtë mënyrë nga AKH-ja me kërkesën e Kontraktorit, do t'i rimburohen AKH-së nga Kontraktori dhe do të përfshihen në kostot e operacioneve hidrokarbure dhe do të jenë të rikuperueshme sipas nenit 9. Rimbursime të tilla do të bëhen në dollarë amerikanë, të llogaritura me kursin e këmbimit që mbizotëron në kohën kur janë kryer shpenzimet nga AKH-ja.

17.15 AKH-ja do të asistojë Kontraktorin, sipas kërkesës, në fitimin e të drejtave të përdorimit ose të drejtave të kalimit mbi tokën private, që kërkohet në lidhje me operacionet hidrokarbure.

Në rastin kur marrëveshja vullnetare nuk mund të arrihet direkt me pronarët e tokës së interesuar, AKH-ja do të ushtrojë të drejtën e shpronësimit të një prone të tillë, në qoftë se është esenciale për operacionet hidrokarbure. Në një rast të tillë, Kontraktori do ta rimburojë AKH-në për të gjitha kostot e arsyeshme të kryera për këto të drejta pronësie, duke pasur parasysh që kosto tilla janë në një linjë me zhdëmtimin e paguar për shpronësimin në raste të ngjashme në Shqipëri.

Kosto të kryera në këtë mënyrë janë të rikuperueshme plotësisht në përputhje me klauzolat e nenit 9.

17.16 AKH-ja do të asistojë Kontraktorin dhe nënkontraktorët e tij, sipas kërkesës, në marrjen nga autoritetet, mbi bazë të aplikimeve të bëra në mënyrën e përshkruar, të gjitha lejet, regjistrirnet, licencat, vizat dhe aprovime të tjera, siç mund të kërkohet për kryerjen e operacioneve hidrokarbure sipas kësaj kontrate, dhe veçanërisht në lidhje me:

17.16.1 hapjen e llogarive bankare;

17.16.2 këmbimin e valutave;

17.16.3 hapësirën e zyrave, lehtësitë e transportimit dhe të komunikimit;

17.16.4 formalitetet e doganave;

17.16.5 vizat e hyrjes dhe të daljes dhe shërbimet mjekësore për punonjësit e Kontraktorit, të cilët do të vijnë në Shqipëri për zbatimin e kësaj kontrate dhe për vartësit e tyre, të cilët do t'i vizitojnë ato ose do të banojnë në Shqipëri;

17.16.6 leje të nevojshme për të nxjerrë jashtë vendit dokumente, të dhëna dhe kampione për analiza ose përpunim për operacionet hidrokarbure;

17.16.7 importimin, transportin dhe përdorimin e të gjitha materialeve që kërkohen për punimet sizmike, karotazhin e puseve dhe çdo operacion tjetër hidrokarbur;

17.16.8 lejet mjedisore.

17.17 AKH-ja, në përputhje me nenin 16.1, do të ketë të drejtën për të gjitha të dhënat origjinale dhe të interpretuara nga operacionet hidrokarbure, duke përfshirë, por pa u kufizuar në raportet gjeologjike, gjeofizike, petrofizike, inxhinierike, karotazheve të puseve dhe të gjendjes së kompletimit të pusit dhe ndonjë të dhëna tjetër që Kontraktori mund ta krijojë gjatë periudhës së kësaj kontrate, në të cilën Kontraktori ka të drejtën të mbajë dhe të përdorë lirisht kopjet.

17.18 AKH-ja do t'i vërë në dispozicion Kontraktorit të gjitha të dhënat teknike të disponueshme nga AKH-ja në lidhje me zonën e kontratës, pa pagesë, brenda tre(3) muajsh nga data efektive, duke pasur parasysh që Kontraktori do ta rimburojë AKH-në për të gjitha kostot e arsyeshme të kryera për përgatitjen e transferimit të këtyre të dhënave dhe koston e kopjimit të tyre.

Të dhënat teknike, në qoftë se janë të disponueshme, do të përfshijnë, por pa u kufizuar:

17.18.1 raportet gjeologjike, të tilla si vrojtme gjeokimi, litostratigrafi, raportet strukturale, petrografi etj;

17.18.2 informacionin e puseve të tillë si matjet e argjilës dhe elektrike, raportet e pusit, kampionet dhe analizat e kampioneve, etj.;

17.18.3 linjat sizmike dixhitale dhe/ose kopjet në letër ose film, hartat bazë, koordinatat UTM, diagramat, etj.;

17.18.4 raportet dhe studimet gjeofizike, të dhënat gravimetrike, të dhënat elektromagnetike, etj.;

17.18.5 raportet e kërkimit dhe studimet rajonale;

17.18.6 të dhëna të prodhimit dhe të rezervuarit.

17.19 Kontraktori do të jetë i lirë të eksportojë kampione për analiza jashtë vendit. Në qoftë se nuk është rënë dakord ndryshe me AKH-në, Kontraktori do të mbajë pjesë të kampioneve të tilla ekuivalente në përmasa dhe në cilësi në Shqipëri.

17.20 Kontraktori do të eksportojë lirisht origjinalet e raporteve të të dhënave teknike, duke pasur parasysh që një regjistrim i krahasueshëm është mbajtur nga Kontraktori ose AKH-ja në Shqipëri.

## Neni 18 Taksimi

18.1 Në bazë të klauzolave të nenit 18, gjatë afateve të kësaj kontrate, çdo kompani individualisht do të jetë subjekt i ligjit të hidrokarbureve në fuqi në Shqipëri në datën efektive në lidhje me fitimin e kompanisë që rrjedh nga pjesa e tij e hidrokarbureve në përputhje me këtë kontratë dhe do të zbatojë kërkesat e atij ligji. Niveli i taksës mbi fitimin në datën efektive është 50% (pesëdhjetë për qind).

18.2 Në qoftë se gjatë afatit të kësaj kontrate, taksa mbi fitimin i kalon pesëdhjetë për qind (50%), atëherë kontrata do të rregullohet në përputhje me klauzolat e nenit 23.3.

18.3 Çdo kompani do të paguajë dhe plotësojë detyrimin për taksën shqiptare mbi fitimin te autoritetet shqiptare të taksës nëpërmjet AKH-së. AKH-ja do të transferojë menjëherë një shumë të tillë të marrë, tek autoriteti i duhur i taksës. Pagesa tek AKH-ja do të përbëjë plotësim të çdo detyrimi të kompanisë për taksën mbi fitimin.

AKH-ja do të kërkojë që autoriteti shqiptar i taksës, menjëherë, të lëshojë dëftesën e duhur zyrtare për çdo kompani për pjesën e tyre, duke evidentuar pagesën e tyre të taksës shqiptare mbi fitimin në nivelin pesëdhjetë për qind (50%) dhe shumën absolute të paguar. Kjo dëftesë do të lëshohet brenda tre (3) muajsh pas mbarimit të një viti kalendarik. Në qoftë se një dëftesë e tillë nuk është lëshuar brenda periudhës së mësipërme, AKH-ja do të dëmshpërblejë dhe zhdëmtojë çdo kompani për ndonjë dëmtim të pësuar nga kompania si rezultat i sa u tha më sipër.

18.4 Kontraktori dhe nënkontraktorët e tij do të jenë të përjashtuar nga pagesa e të gjitha taksave të tjera, duke përfshirë por pa u kufizuar në TVSH-në ose ndonjë formë ekuivalente të taksës bazuar në vlerën e shitjeve, tatimeve, taksave, akcizës ose pagesave të cilat në ndonjë kohë mund të jenë të aplikueshme sipas ligjeve të Shqipërisë, midis të tjerave, në lidhje me pasurinë, kapitalin, duke përfshirë ndonjë taksë të vendosur mbi shitjet, të ardhurat bruto ose transferimin e pasurisë dhe tarifatat për ose në lidhje me operacionet hidrokarbure të kryera sipas kontratës, përveç taksës së fitimit siç specifikohet në nenin 18.1.

Punonjësit e huaj të Kontraktorit dhe nënkontraktorëve të tij, do të jenë përjashtuar nga pagimi i taksës mbi të ardhurat personale në Shqipëri.

Përjashtimet e reshtuara më sipër nuk përfshijnë portet normale, magazinat ose tarifatat postare dhe pagesa të tjera të ngjashme për shërbime që janë vendosur aktualisht.

18.5 Njëkohësisht, me miratimin e planit të zhvillimit, AKH-ja dhe Kontraktori do të bien dakord nëse taksa mbi fitimin do të paguhet *cash* (me para në dorë) apo në natyrë dhe mbi mekanizmin e përshtatshëm të pagesës. Taksa mbi fitimin, e cila i korrespondon shitjeve të gazit natyror, do të paguhet në *cash* (me para në dorë) nëse studimi i marketimit në përputhje me nenin 8.3.7 përcakton që për Kontraktorin nuk është e arsyeshme ekonomikisht që ta paguajë këtë taksë në natyrë. Në rast se Palët bien dakord që taksa do paguhet në natyrë, atëherë kjo marrëveshje në mënyrë të ndërsjellë do të këtë klauzola në lidhje me ndarjen e sasive të ndryshme të hidrokarbureve dhe procedurat për rastin e marrjes me tepricë apo me mangësi të pjesës së AKH-së.

18.6 Në qoftë se, përveç përjashtimeve të përcaktuara në këtë nen ose nenin 19, ndonjë prej personave ose njësive të përjashtuara do t'i kërkohej të bëjë ndonjë pagesë, Kontraktori mundet, me zgjedhjen e tij të vetme, ose t'i kërkojë AKH-së rimbursimin e një pagese të tillë, në valutën që kjo

pagesë është bërë, brenda tridhjetë (30) ditësh nga bërja e kërkesës, ose do të ketë të drejtën ta kompensojë ndaj ndonjë pagese tjetër ndaj AKH-së, ose do të marrë një numër të tillë barrelash nga pjesa e AKH-së mbi hidrokarburet kosto teprice, e cila, e vlerësuar me *fair market value*, i korrespondon shumës së pagesave të tilla.

18.7 Për qëllim të taksave shqiptare, çdo kompani do të mbajë libra regjistrimi në dollarë amerikanë dhe do të përgatisë taksën vjetore në dollarë amerikanë dhe lekë shqiptarë.

## Neni 19 Importet dhe eksportet

19.1 Kontraktori dhe nënkontraktorët e tij të angazhuar në kryerjen e operacioneve hidrokarbure sipas kësaj kontrate, do të lejohen të importojnë dhe do të jenë të përjashtuar nga taksat doganore, licenca e importit dhe leje e tarifa të tjera (me përjashtim pagesave të portit dhe magazinave që aplikohen përgjithësisht në Shqipëri për këto shërbime të kryera ndaj Kontraktorit) në lidhje me importimin e makinerive, pajisjeve, pajisjeve të radiove, automjeteve të të gjitha llojeve dhe të çfarëdo numri, duke përfshirë, por pa u kufizuar në autobuzë dhe vetura që përdorin benzinë ose diesel, anije të nevojshme, avionë dhe helikopterë, materiale, furnizime (duke përfshirë eksplozivët), artikuj të konsumueshëm, pasuri të luajtshme dhe pjesë këmbimi për ndonjë nga artikujt e mësipërm, që do të përdoren në operacionet hidrokarbure në përputhje me këtë kontratë. Për këtë qëllim, Kontraktori dhe nënkontraktorët e tij do të jenë të përjashtuar nga ndonjë ndalim, kufizim dhe shtrëngesë nga importi dhe nga vendi i origjinës.

19.2 Çdo punonjës i huaj i Kontraktorit dhe nënkontraktorëve të tij do të lejohet të importojë dhe do të jetë i përjashtuar nga të gjitha taksat doganore, licenca e importit dhe leje e tarifa të tjera (me përjashtim të pagesave të portit dhe të magazinave që aplikohen përgjithësisht në Shqipëri për këto shërbime të kryera ndaj tyre) për dhe në lidhje me përdorimin personal, mjete për mirëmbajtjen e shtëpisë dhe sende të konsumueshme, duke përfshirë automjetin e tij, megjithatë duke pasur parasysh që këto pasuri janë importuar vetëm për përdorimin nga punonjësi i huaj dhe familja e tij.

19.3 Përjashtimi i parashikuar në nenin 19.1 nuk do të aplikohet në ndonjë artikull të importuar kur artikujt e të njëjtit ose substancialisht të të njëjtit lloj dhe cilësie, prodhohen në vend dhe janë të disponueshëm për blerje ose për t'u marrë me qira dhe të lëvrueshme në kohë në Shqipëri me një çmim jo më të lartë se kosto e artikujve të importuar përpara taksës doganore, por pas shtimit të kostove të transportimit dhe të asiguracionit.

19.4 Me miratim të AKH-së, ndonjë nga artikujt për të cilët është rikuperuar kostoja, ndonjë nga artikujt e importuar në Shqipëri, përjashtuar ose jo nga taksa doganore në përputhje me këtë nen, i cili nuk i është shitur Palëve të treta në Shqipëri në përputhje me nenin 19.5, mund të eksportohen nga Pala që e ka importuar, në çdo kohë pas njoftimit të zyrës së doganës, pa bërë pagimin e ndonjë takse, tarife eksporti ose të drejte.

19.5 Me aprovimin e AKH-së, ndonjë nga artikujt për të cilët është rikuperuar kostoja, të rinj ose të përdorur por në gjendje pune, material, pajisje ose mjete të përdorura në operacionet hidrokarbure nga Kontraktori, si dhe artikujt që përdoren në shtëpi, artikujt të përdorimit personal, të cilët i përkasin personelit të Kontraktorit dhe nënkontraktorëve të tij, mund të shiten brenda Shqipërisë, duke pasur parasysh që blerësi të paguajë taksën doganore të aplikueshme, në qoftë se ka, te zyra e doganës, me përjashtim të rastit kur i shitet AKH-së, ose ndonjë njësi tjetër që gëzon të njëjtat përjashtime si Kontraktori.

19.6 Me aprovimin e AKH-së, ndonjë nga artikujt për të cilët është rikuperuar kostoja, material pajisje dhe mjete të dëmtuara ose të përdorura aq sa janë bërë të papërdorshme dhe të cilat janë klasifikuar nga Kontraktori si hekurishte ose mbeturina, mund të shiten si hekurishte ose mbeturina pa pagesë të taksës doganore nga Kontraktori dhe nënkontraktorët e tij.

19.7 Në rastin kur shitje të tilla sipas nenit 19.5 (me përjashtim të pajisjeve shtëpijake, artikujve dhe mjeteve personale të zotëruara nga punonjësit e Kontraktorit dhe nënkontraktorët tij) dhe 19.6 më sipër, të ardhurat nga shitje të tilla do të ndahen në mënyrën e mëposhtme:

Kontraktori do të ketë të drejtën të marrë të ardhura, të cilat (neto pa taksat doganore) kur merren, do të zvogëlojnë kostot e parikuperuara, në qoftë se ka, të cilat Kontraktori ka të drejtën t'i



rikuperojë në përputhje në nenin 9. Në qoftë se nuk kanë mbetur kosto për t'u rikuperuar nga Kontraktori, atëherë të gjitha të ardhurat (neto pa taksat doganore) e shitjeve të tilla do t'i paguhet AKH-së.

19.8 Kontraktori nuk do t'i kërkohet të marrë një licencë dhe do të jetë i përjashtuar nga taksat, tarifat ose ndonjë detyrim tjetër financiar, në lidhje me eksportimin e hidrokarbureve nga Shqipëria.

19.9 AKH-ja do të bashkëpunojë me Kontraktorin, me qëllim që të lehtësojë operacionet e importit dhe të eksportit, duke përfshirë procedurat e çmimeve, të reduktuara, sipas kësaj kontrate.

## Neni 20

### **Librat e llogarive, monedha, kontrolli i këmbimeve dhe pagesat**

20.1 Kontraktori do të mbajë, në zyrën e tij në Shqipëri, librat e llogarisë në përputhje me procedurën llogaritëse dhe me praktikat llogaritëse përgjithësisht të përdorura në industrinë ndërkombëtare të naftës dhe libra e regjistrime të tjera siç mund të jetë e nevojshme për të treguar punën e kryer sipas kësaj kontrate, duke përfshirë sasinë e të gjithë hidrokarbureve të disponueshme.

20.2 Kontraktori do të mbajë librat e tij të llogarisë dhe regjistrimet e llogarisë, duke përfshirë llogarinë e kostos, në dollarë amerikanë.

20.3 Kontraktori do të mbajë një llogari bankare në dollarë amerikanë dhe një llogari bankare në lekë shqiptare. Të gjitha pagesat nga llogaria në dollarë amerikanë, të bëra në valutë tjetër nga dollarët amerikanë, do të regjistrohen në libra në dollarë amerikanë me kursin e këmbimit në fuqi në kohën e transaksionit. Vlerësimet e bëra në valuta të tjera nga dollarët amerikanë do të regjistrohen në libra në dollarë amerikanë me kursin e këmbimit në fuqi në kohën kur është bërë vlerësimi. Kursi i këmbimit për vlerësime të tilla do të përcaktohet duke përdorur mesataren e kursit të blerjes dhe të shitjes së valutës për ditën në të cilën kryhet transaksioni, siç kuotohet në "Financial Time" (botimi i Londrës), ose kurse të tilla të kuotuar, siç mund të bihet dakord nga të dyja Palët. Për transaksione që kryhen në datën kur publikimi i kursit të këmbimit nuk bëhet, kursi i këmbimit do të përcaktohet duke iu referuar kursit të publikuar në datën e menjëhershme paraardhëse.

Të gjitha pagesat në lekë shqiptare do të kthehen në dollarë amerikanë, me kursin mesatar zyrtar të blerjes të botuar nga Banka Qendrore e Shqipërisë, për muajin në të cilin shpenzimet/kreditë janë regjistruar në libra.

As AKH-ja dhe as Kontraktori nuk duhet të kenë raste fitimi ose humbjeje nga këmbimi në disfavor ose në përfitim të një Pale tjetër. Ndonjë humbje ose fitim në këmbimin e valutës që rezulton nga diferenca në kurset e këmbimit për qëllime të llogaritjes, siç përmendet më sipër, dhe kursit aktual të këmbimit, kur blihet valuta korresponduese që nuk është dollarë amerikanë, për qëllim të pagesave, do të ngarkohet në mënyrë të vazhdueshme ose kreditohet në llogarinë e kostos.

20.4 Çdo pagesë që AKH-së i kërkohet t'ia bëjë Kontraktorit ose Kontraktori i kërkohet t'ia bëjë AKH-së, do të paguhet në dollarë amerikanë, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas mbarimit të muajit në të cilin ndodh detyrimi për të bërë një pagesë të tillë.

20.5 Për qëllim të kësaj kontrate, Kontraktori do të ketë liri të plotë për:

20.5.1 të hapur, operuar dhe mbajtur lirisht llogari bankare si brenda, ashtu dhe jashtë Shqipërisë;

20.5.2 të marrë dhe të mbajë jashtë Shqipërisë dhe të disponojë lirisht valutë të huaj të marrë nga ai jashtë Shqipërisë, duke përfshirë të ardhurat e shitjes së hidrokarbureve dhe Kontraktori nuk do të jetë i detyruar të sjellë të ardhura të tilla në Shqipëri, me përjashtim të atyre të ardhurave siç mund t'i nevojiten, sipas gjykimit të Kontraktorit për të mbuluar shpenzimet në Shqipëri;

20.5.3 të paguar direkt jashtë Shqipërisë për blerjen e mallrave dhe shërbimeve të nevojshme për të kryer operacionet hidrokarbure;

20.5.4 të paguajë punonjësit e tij të huaj, që punojnë në Shqipëri, në monedhë të huaj jashtë Shqipërisë, këtyre punonjësve të huaj do t'u kërkohet të sjellin në Shqipëri vetëm një sasi valutë të tillë që kërkohet për të mbuluar shpenzimet e tyre personale të jetesës;

20.5.5 të riadhesojë në mënyrë të plotë gjitha të ardhurat e Kontraktorit nga operacionet hidrokarbure në Shqipëri, duke përfshirë, por pa u kufizuar, në të ardhurat nga shitjet e aseteve dhe hidrokarbureve;

20.5.6 eksportojë dhe importojë lirisht valutë të huaj dhe të mbajë brenda Shqipërisë llogaritë në valute të huaj.

20.6 Në rastin kur një Palë nuk arrin të kryejë pagesat sipas kësaj kontrate në datën e caktuar, do të ngarkohet interes për shumën e papaguar. Norma e interesit të aplikuar do të jetë LIBOR-i tremujor për depozitat në dollarë amerikanë, të marrë në ditën e parë të kalimit të afatit të pagesës, plus 2.5 pikë përqindje, që publikohet nga National Westminster Bank Limited, London në orën 11 paradreke.

## Neni 21

### **Transferimi i të drejtave**

21.1 Në përputhje me nenet 21.2 dhe 21.3, çdo kompani do të ketë të drejtën vetëm të shesë, të transferojë, të japë ose të disponojë (që më poshtë në mënyrë të përbashkët do të referohet si “të transferojë”) të gjithë ose një pjesë të të drejtave të tij, interesave dhe detyrimeve sipas kësaj kontrate, ndonjë personi me miratimin me shkrim të AKH-së, miratim i cili nuk do të refuzohet në qoftë se transferuesi demonstron aftësitë e tij teknike dhe financiare dhe sigurohet që ky transferues do të marrë detyrimet dhe përgjegjësitë e njësisë transferuese që parashikohen këtu dhe, për më tej, duke u siguruar që ky transferues paraqet një garanci nga kompania mëmë që zbatohet në mënyrën e duhur, që mbulon interesat e tij të transferuara në një format të tillë siç tregohet në aneksin “D” këtu.

21.2 Çdo kompani do të jetë e lirë të transferojë të drejtat, interesat dhe detyrimet tij filialeve të kësaj kompanie, duke pasur parasysh që një transferues i tillë merr përsipër detyrimet dhe përgjegjësitë e parashikuara të njësisë transferuese dhe i jep njoftim të menjëhershëm AKH-së.

21.3 Çdo kompani do të jetë e lirë t’ia transferojë të drejtat, interesat dhe detyrimet e tij ndonjë kompanie tjetër, duke pasur parasysh që një transferues i tillë merr përsipër detyrimet dhe përgjegjësitë e parashikuara të njësisë transferuese dhe i jep njoftim të menjëhershëm AKH-së.

21.4 Asnjë taksë, tarifë ose ndonjë lloj tjetër pagese nuk do bëhet si rezultat i transferimit nga ndonjë kompani.

## Neni 22

### **Forca madhore**

22.1 Moskryerja ose vonesa në kryerjen nga Kontraktori të ndonjë detyrimi në përputhje me këtë kontratë, do të justifikohet në qoftë se, dhe në masën që, një moskryerje ose vonese e tillë është shkaktuar nga forca madhore. Periudha e një moskryerjeje ose vonesë të tillë, së bashku me një periudhë të tillë që mund të jetë e nevojshme për riparimin e ndonjë dëmtimi të bërë gjatë një vonese të tillë, do të shtohet në kohën e dhënë në këtë kontratë për kryerjen ose ushtrimin e një detyrimi të tillë dhe të ndonjë të drejte dhe detyrimi që varet nga ai dhe rrjedhimisht në termat e kësaj kontrate.

22.2 “Forca madhore”, brenda kuptimit të nenit 22, do të jetë ndonjë ngjarje e paparashikuar si një revoltë, kryengritje, luftë, grevë ose shqetësime gjatë punës, zjarre, përmytje, veprime qeveritare ose ndonjë shkak tjetër, jashtë kontrollit të arsyeshëm të Palës që kërkon forcën madhore.

22.3 Pala që kërkon forcë madhore do t’i japë njoftim Palës tjetër sa më shpejt që të jetë e mundur me detajet e arsyeshme.

22.4 Në qoftë se ngjarja e forcës madhore ndodh gjatë periudhës së kërkimit ose periudhës së vlerësimit dhe vazhdon të jetë në fuqi për një periudhë prej gjashtë (6) muajsh, Kontraktori do të ketë mundësinë që në çdo kohë pas kësaj, pas një njoftimi me shkrim AKH-së nëntëdhjetë (90) ditë përpara, ta përfundojë këtë marrëveshje pa përgjegjësi të mëtejshme të çfarëdolloji.

## Neni 23 Ligji udhëheqës

23.1 Palët bien dakord që ligjet e Shqipërisë janë të aplikueshme me njohjen e duhur të parimeve të ligjit të pranuar ndërkombëtarisht.

23.2 AKH-ja ka parasysh që Kontraktori ka hyrë në këtë kontratë në përputhje me ligjet, rregullat dhe rregulloret në Shqipëri siç ekzistojnë ato në datën efektive të kësaj kontrate, dhe AKH-ja konfirmon që të gjitha të drejtat të dhëna Kontraktorit janë në përputhje me këto ligje, rregulla dhe rregullore,

23.3 Është rënë dakord midis palëve që, në qoftë se ligjet e Shqipërisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjet e taksave dhe rregullat e shkëmbimeve të jashtme, pas firmosjes së kësaj kontrate, do të ndryshohen në mënyrë të tillë që të zvogëlojnë të drejtat dhe përfitimet e Kontraktorit ose të zgjerojnë detyrimet e Kontraktorit, AKH-ja do të bëjë rirregullimin e kontratës në mënyrë që të ruhen të drejtat, përfitimet dhe detyrimet e Kontraktorit siç ekzistojnë në datën efektive.

23.4 Në rastin kur ndonjë ndryshim në ligjet, rregullat ose rregulloret e Shqipërisë ndodh pas datës efektive të kontratës, e cila materialisht ngushton ose kufizon ndonjë të drejtë ose përfitim të Kontraktorit ose që materialisht rrit detyrimet e Kontraktorit sipas kësaj kontrate ose sipas ndonjë ligji, rregulli ose rregulloreje të Shqipërisë, nga ato të datës efektive, Kontraktori, në çdo kohë, mundet të njoftojë AKH-në me shkrim.

Brenda tridhjetë (30) ditësh nga marrja e këtij njoftimi, AKH-ja dhe Kontraktori do të takohen të negociojnë në mirëbesim dhe të bien dakord për ndryshimet të cilat nevojiten të bëhen në termat e kësaj kontrate, për të ruajtur të drejtat dhe përfitimet ekonomike të Kontraktorit në përputhje me nenin 23.3. Në rastin kur Palët nuk arrijnë të bien dakord, brenda nëntëdhjetë (90) ditësh pas njoftimit të Kontraktorit AKH-së, secila Palë mund t'ia referojë problemin ose problemet në diskutim, arbitrazhit sipas nenit 24. Arbitrat në një rast të tillë do të autorizohen të përcaktojnë nëse ka ndodhur një ndryshim material në të drejtat, përfitimet ose detyrimet e Kontraktorit dhe të përcaktojnë modifikimet në kontratë, nëse është e nevojshme, për të ruajtur të drejtat ekonomike dhe përfitimet e Kontraktorit në një nivel ekuivalent me atë që do të kishin pasur, në qoftë se ndryshime të tilla nuk do të kishin ndodhur. Ndryshimi i termave të kësaj kontrate sipas përcaktimit të arbitrave do të bëhet efektiv, pasi të kalojë për miratim në Këshillin e Ministrave dhe të bëhet si i tillë pjesë e kësaj kontrate.

## Neni 24 Arbitrazhi

24.1 Çdo mosmarrëveshje, konflikt, pretendim ose diferencë në opinion, duke përfshirë ndonjë përfundim të pretenduar sipas nenit 27 nga ose në lidhje me këtë kontratë ose prishjen, përfundimin ose vlefshmërinë e saj, ose me operacionet hidrokarbure të kryera, do të vendoset përfundimisht nga arbitrazhi në përputhje me rregullat e arbitrazhit të UNCITRAL-it ("Rregullat").

24.2 Në lidhje me sa më sipër, autoriteti i caktuar sipas rregullave do të jetë presidenti i Gjykatës së Arbitrazhit Ndërkombëtar i Dhomës të Tregtisë në Paris, Francë.

24.3 Numri i arbitrave do të jetë tre. Pala që i drejtohet arbitrazhit do të caktojë një arbitër dhe Pala që përgjigjet do të caktojë një arbitër tjetër, dhe në rastin e dështimit të kësaj Pale që përgjigjet, të caktojë një arbitër brenda tridhjetë (30) ditësh, Pala që i drejtohet arbitrazhit mund t'i kërkojë autoritetit emëruar të caktojë një arbitër të dytë në përputhje me rregullat. Dy (2) arbitrat e caktuar në këtë mënyrë do të caktojnë arbitrin e tretë, i cili do të veprojë si arbitri kryesor në gjyq.

24.4 Në qoftë se brenda tridhjetë (30) ditësh nga caktimi i arbitrit të dytë, të dy (2) arbitrat nuk bien dakord për arbitrin e tretë, secila Palë mund t'i kërkojë autoritetit caktues të caktojë arbitrin e tretë.

24.5 Arbitrazhi do të zhvillohet në Zyrin, Zvicër. Gjuha që do të përdoret në procedurat e arbitrazhit do të jetë anglishtja. Palët shprehimisht heqin dorë nga çdo e drejtë për të apeluar një vendim arbitral në ndonjë gjykatë çfarëdo qoftë dhe vendimi arbitral do të jetë përfundimtar dhe detyrues për Palët.

24.6 Vendimi arbitral do të përmbajë arsyen mbi të cilën vendimi është bazuar dhe një vendim për kostot.

24.7 Të drejtat për arbitrazh sipas nenit 24 do të vazhdojnë të ekzistojnë edhe pas përfundimit të kësaj Kontrate.

24.8 AKH-ja shprehimisht heq dorë nga ndonjë e drejtë që të kërkojë imunitet në lidhje me ndonjë procedurë të përcaktuar në përputhje me nenin 24, ndonjë procedurë për të detyruar zbatimin e nenit 24, ose ndonjë procedurë detyrimi për ndonjë vendim të marrë nga arbitrazhi sipas nenit 24.

24.9 Gjykim për një vendim të marrë mund të bëhet nga një gjykatë që ka juridiksion, ose aplikimi mund të bëhet në një gjykatë të tillë për një pranim juridik të vendimit dhe një urdhër detyrues, siç mund të jetë rasti.

24.10 Çdo çështje e pazgjidhur midis AKH-së dhe Kontraktorit, e cila, sipas termave të kësaj kontrate, i duhet drejtuar një ekspert, do t'i drejtohet për përcaktim një ekspert të vetëm. Ekspertit do t'i jepen termat e referencës për të cilat do të bihet dakord nga të dyja Palët. Eksperti do të caktohet me marrëveshje ndërmjet AKH-së dhe Kontraktorit. Në qoftë se AKH-ja dhe Kontraktori nuk arrijnë të caktojnë një ekspert brenda tridhjetë (30) ditësh pasi është arritur marrëveshja për termat e referencës, secila Palë mund të aplikojë në Dhomën Ndërkombëtare të Qendrës së Tregtisë për Ekspertizën Teknike, Paris, Francë, për caktimin e një eksperti në përputhje me rregulloren e tij. Eksperti do të bëjë përcaktimin e tij në përputhje me klauzolat që përmbahen këtu, bazuar në evidencën që disponon ai. Përfaqësuesit e AKH-së dhe të Kontraktorit do të kenë të drejtë të konsultohen me ekspertin dhe ta furnizojnë atë me të dhëna dhe informacion, duke pasur parasysh që eksperti mund të imponojë kufizime të arsyeshme për këtë të drejtë. Të dhëna dhe informacione të tilla duhet t'i jepen edhe palës tjetër në mosmarrëveshje në të njëjtën kohë. Eksperti do të jetë i lirë të vlerësojë masën në të cilën çdo e dhënë, informacion dhe evidencë tjetër është e pranueshme. Tarifa dhe shpenzimet e ekspertit dhe kostot e lidhura me një emërim, nëse ka, bërë nga Dhoma Ndërkombëtare e Qendrës së Tregtisë për Ekspertizën Teknike, do të mbulohen në mënyrë të barabartë nga AKH-ja dhe Kontraktori. Përcaktimi i ekspertit do të jetë përfundimtar dhe i detyrueshëm për palët, subjekt i ndonjë gabimi të dukshëm në përcaktimin e tij.

## Neni 25

### **Masat e mbrojtjes së mjedisit dhe sigurisë, parandalimi i humbjeve**

25.1 Kontraktori do të kryejë operacionet hidrokarbure në mënyrë të sigurt dhe të përshtatshme në përputhje me ligjet e mjedisit dhe rregulloret e Republikës së Shqipërisë, si dhe me praktikat përgjithësisht të pranura të industrisë ndërkombëtare të naftës dhe do të shkaktojë sa më pak dëmtim që është praktikisht e arsyeshme, në mjedisin e përgjithshëm, duke përfshirë inter alia, sipërfaqen, ajrin, liqenet, lumenjtë, detin, jetën e kafshëve, jetën e bimëve, drithërat, burimet e tjera natyrore dhe pasuritë.

25.2 Në rastin e një fontane, aksidenti ose urgjence, Kontraktori do të ndërmarrë të gjitha hapat e menjëhershme për të marrë situatën e urgjencës nën kontroll dhe të mbrojë ndaj humbjes së jetës dhe humbjes ose dëmtimit të pasurisë dhe të parandalojë dëmtimin e burimeve natyrore dhe të mjedisit në përgjithësi.

25.3 Në rastin kur AKH-ja, në mënyrë të arsyeshme, përcakton që ndonjë punë ose instalim ndërtuar nga Kontraktori ose ndonjë operacion hidrokarbur i kryer nga Kontraktori rrezikon ose mund të rrezikojë personat ose pasurinë e palëve të treta, ose shkakton ndotje ose dëmton mjedisin në një shkallë të papranueshme, AKH-ja mund t'i kërkojë Kontraktorit të marrë masa riparuese brenda një periudhe të arsyeshme dhe të riparojë ndonjë dëmtim të mjedisit.

Në rastin kur AKH-ja e konsideron të nevojshme, ajo gjithashtu, mund t'i kërkojë Kontraktorit t'i ndërpresë operacionet hidrokarbure në përgjithësi ose pjesërisht, derisa Kontraktori të ketë marrë masa të tilla riparuese ose të ketë riparuar ndonjë dëmtim.

Në rastin kur Kontraktori dështon në marrjen e masave riparuese të kërkuara nga AKH-ja brenda një periudhe kohe të përcaktuar për këtë, AKH-ja mund të marrë masa të tilla riparuese për llogari të Kontraktorit.

25.4 Kontraktori, përpara se të kryejë operacione sizmike, shpimi, zhvillimi ose prodhimi, do të ndërmarrë një studim për vlerësimin e mjedisit. Kontraktori nuk do të jetë përgjegjës për ndonjë dëmtim të mjedisit, ndodhur përpara këtyre operacioneve.

25.5 Kontraktori do të marrë të gjitha masat e arsyeshme brenda kontrollit të tij, në përputhje me standardet përgjithësisht të pranuar në industrinë ndërkombëtare të naftës për të parandaluar humbjet ose derdhjet e hidrokarbureve sipër ose nën tokë gjatë kryerjes së operacioneve hidrokarbure.

## Neni 26 Mallrat dhe shërbimet

26. 1 Kontraktori, kontraktorët e tij dhe nënkontraktorët:

26.1.1 Do t'u japin prioritet kontraktorëve lokalë për aq kohë sa çmimet, cilësia e materialeve dhe shërbimeve dhe disponueshmëria e tyre në kohë janë, sipas opinionit të Kontraktorit, të krahasueshme me materialet dhe shërbimet e disponueshme në tregun ndërkombëtar.

26.1.2 Do t'u japin preferencë materialeve të prodhuara në vend, pajisjeve, makinerive dhe artikujve të konsumueshëm, për aq kohë sa çmimet e tyre, cilësia dhe disponueshmëria në kohë janë, sipas opinionit të Kontraktorit, të krahasueshme me materialet, pajisjet, makineritë dhe artikujt e konsumueshëm të disponueshëm në tregun ndërkombëtar.

Për qëllimet e mësipërme, çmimet për materialet, pajisjet, makineritë dhe artikujt e konsumueshëm të prodhuar në vend dhe shërbimet e kontraktorëve lokalë do të krahasohen me çmimet e materialeve dhe shërbimeve në tregun ndërkombëtar pasi janë shtuar kostot e transportimit dhe të asiguracionit.

26.2 Kontraktori do të organizojë ankande konkurruese për çdo punë të kryer në përputhje me programin e punës dhe buxhetin, në qoftë se një punë e tillë do të parashikohet të kalojë një milion dollarë amerikanë (1 000 000. 00 US\$).

## Neni 27 Abandonimi

Kontraktori, me kërkesën në kohë të AKH-së, do të heqë ndonjë instalim ose strukturë të ndërtuar nga Kontraktori për qëllime të kësaj kontrate dhe të cilat janë abandonuar ose që iu ka kaluar koha e përdorimit, gjatë kohës ose në mbarim të kësaj kontrate.

Heqja që përmendet më sipër dhe detyrime të tjera për abandonim, do të jenë subjekt dhe do të përcaktohen në përputhje me klauzolat e mëposhtme:

27.1 Kontraktori, në konsultim me AKH-në, do të përgatisë dhe do t'i paraqesë AKH-së, një plan abandonimi (që këtu më poshtë do të referohet si “Plani i abandonimit”), duke përfshirë një përshkrim të detajuar teknik dhe inxhinierik të masave të abandonimit dhe të lëvizjes, në përputhje me detyrimet e sipërpërmendura, të cilat ai dëshiron t'i kryejë në përfundim të prodhimit nga zona e zhvillimit dhe e prodhimit në diskutim.

27.2 Jo më vonë se 180 ditë përpara datës së cilës i referohet neni 27.3 më poshtë, Kontraktori do të përgatisë dhe do të paraqesë në Komitetin Këshillimor një buxhet të detajuar (që më poshtë do të quhet “Buxheti i abandonimit”), duke detajuar koston e vlerësuar për planin e abandonimit.

27.3 Dhjetë (10) vjet para datës së përfundimit të operacioneve i prodhimit sipas vlerësimit të Kontraktorit ose në fund të tremujorit në të cilën prodhimi kumulativ arrin shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të hidrokarbureve të rikuperueshme të pritshme, cilado që të ndodhë më shpejt, një sasi e barabartë me buxhetin e abandonimit, e llogaritur në bazë të njësive të prodhimit mbi hidrokarburet e rikuperueshme të mbetura të pritshme nga zona e kontratës, do të grumbullohet në një llogari kostoje për t'u përdorur për të mbuluar kostot e abandonimit, sasi e cila do të jetë e rikuperueshme nga Kontraktori në përputhje me nenin 9.

27.4 Në përvjetorin e parë të datës së referuar në nenin 27.3 më sipër dhe në një bazë vjetore më vonë, Palët do të mblidhen për të rivlerësuar buxhetin e abandonimit të vlerësuar dhe, në qoftë se është e nevojshme, do ta rishikojnë këtë buxhet abandonimi në të cilin Palët do të bien gjithashtu dakord për ndonjë korrigjim, si rrjedhim i saj, që i duhet bërë shumës që do të vendoset në llogarinë e kostos.

27.5 Jo më vonë se njëqind e tetëdhjetë (180) ditë para datës së vlerësuar të përfundimit të operacioneve hidrokarbure, Kontraktori do të përgatisë dhe do të paraqesë para Komitetit Këshillimor, në përputhje me nenin 5.1.5.3, një plan abandonimi përfundimtar të rishikuar, në përputhje me detyrimet e sipërpërmendura të Kontraktorit. Brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh nga aprovimi i këtij plani abandonimi, Kontraktori do të përgatisë dhe do të paraqesë në AKH një buxhet abandonimi përfundimtar. Në qoftë se shumat e parashikuara në llogarinë e kostos (që më poshtë do të referohet si “Diferenca e kostos”) janë të pamjaftueshme për të mbuluar buxhetin e abandonimit të përmendur më sipër, një sasi shtesë e barabartë me diferencën e kostos do të regjistrohet në llogarinë e kostos dhe do të rikuperohet nga Kontraktori, në përputhje me nenin 9.

27.6 Kontraktori do të kryejë operacionet e lëvizjes dhe të abandonimit të specifikuar në planin e abandonimit dhe këto shpenzime do të zvogëlojnë llogarinë e kostos. Ndonjë balancë në llogarinë e kostos e mbetur pas përfundimit të operacioneve hidrokarbure, do të ndahet midis Palëve në përputhje me nenin 10, në një ndarje të tillë që është aplikuar menjëherë përpara abandonimit të operacioneve hidrokarbure.

27.7 Shumat e grumbulluara në llogarinë e kostos për qëllimet e abandonimit do të konsiderohen si kosto të operacioneve hidrokarbure për llogaritjen e faktorit R.

## Neni 28 Konfidencialiteti

28.1 Me përjashtim të rastit kur në këtë kontratë parashikohet ndryshe, i gjithë informacioni i marrë sipas kësaj kontrate do të mbahet nga Palët në konfidencialitet të plotë dhe nuk do të bëhet publike pa miratimin me shkrim të mëparshëm të Palës tjetër, përsa kohë kjo kontratë është në fuqi, me përjashtim të kërkesave për të vepruar në përputhje me ligjet, rregullat ose rregulloret e AKH-së ose ndonjë agjencie tjetër, ose bursave në të cilat AKH-ja ose një kompani mund të jetë subjekt, në qoftë se ky informacion nuk bëhet pjesë e përdorimit publik nëpërmjet burimeve të tjera përveç AKH-së dhe një kompanie. Për më tepër, kompanitë do të jenë të detyruara nga kushtet e konfidencialitetit për një periudhë prej pesë (5) vjetësh pas mbarimit të kësaj kontrate.

28.2 AKH-ja dhe çdo kompani (siç përcaktohet në nenin 21) mund t’ua paraqesin ndonjë informacion të tillë punonjësve të tyre, filialeve, konsulentëve ose nënkontraktorëve në masën e kërkuar për një kryerje më efektive të operacioneve hidrokarbure, duke pasur parasysh që, në rastin e një paraqitjeje të informacionit punonjësve dhe filialeve, duhet të sigurojë në mënyrë të përshtatshme mbrojtjen e natyrës konfidenciale të informacionit të interesuar dhe, në rastin e paraqitjes së informacionit konsulentëve ose nënkontraktorëve, të sigurohet që marrësit e mësipërm të kenë hyrë më parë në një marrëveshje konfidencialiteti.

28.3 Për qëllimin e marrjes së ofertave të reja për pjesët e zonës së kontratës nga të cilat është hequr dorë ose në zonat pranë zonës së kontratës, AKH-ja mund t’i tregojë ndonjë njësi tjetër të dhëna për këto pjesë nga të cilat është hequr dorë, të dhëna në formën bazë dhe të painederpretuara, gjatë termave të kësaj kontrate.

28.4 Pasi të bëhet një marrëveshje konfidencialiteti, siç parashikohet në nenin 28.2 më sipër, secila Palë mund të paraqesë një informacion të tillë të marrë sipas kësaj kontrate, sipas kërkesës së institucioneve financiare, nga të cilat Pala që bën paraqitjen është duke kërkuar financim për qëllim plotësimin e detyrimeve që parashikohen këtu.

28.5 Pasi të bëhet një marrëveshje konfidencialiteti, çdo kompani mund t’u tregojë ndonjë informacion të tillë në mirëbesim transferuesve potencialë të interesave, të cilët kanë interes në të drejtat e hidrokarbureve të dhëna Kontraktorit sipas kësaj kontrate.

## Neni 29 **Përfundimi**

29.1 Kjo kontratë mund të përfundohet nga Kontraktori duke i dhënë një njoftim me shkrim AKH-së, jo më pak se tridhjetë (30) ditë para, duke pasur parasysh që një përfundim i tillë nuk e liron Kontraktorin nga ndonjë detyrim i papërfunduar përpara një përfundimi të tillë.

29.2 Kjo kontratë mund të përfundohet nga AKH-ja duke i dhënë një njoftim me shkrim Kontraktorit jo më pak se njëqind e njëzet (120) ditë para, në rastet e mëposhtme:

29.2.1 Në qoftë se Kontraktori, në mënyrë të përsëritur, ka kryer një shkelje materiale të një detyrimi të tij themelor sipas kësaj kontrate dhe është këshilluar nga AKH-ja për qëllimin e AKH-së për të përfunduar këtë kontratë. Një njoftim i tillë për përfundimin nga AKH-ja do të jepet vetëm në qoftë se Kontraktori, pas marrjes së njoftimit nga AKH-ja që ai është në shkelje materiale dhe nuk e ka rregulluar ose nuk ka filluar ta rregullojë në mënyrë themelore një shkelje të tillë brenda gjashtë (6) muajsh.

29.2.2 Në qoftë se Kontraktori nuk zbaton në mënyrë thelbësore vendimin përfundimtar që rezulton nga një procedurë arbitrazhi në përputhje me nenin 24.

29.2.3 Në qoftë se Kontraktori gjykohet i falimentuar nga një gjykatë kompetente ose në qoftë se ka më shumë se një njësi që përbën Kontraktorin dhe ndonjë prej tyre është deklaruar i falimentuar dhe njësitë e tjera ose njësia tjetër nuk ndërmerr veprimet e përshtatshme për të përmirësuar situatën në lidhje me këtë kontratë.

Përfundimi nga AKH-ja, në përputhje me nenin 29.2, nuk do të çlirojë Kontraktorin nga ndonjë detyrim i paplotësuar përpara këtij përfundimi.

29.3 Subjekt i përfundimit të mëparshëm në përputhje me nenet 29.1 ose 29.2, kjo kontratë do të përfundojë automatikisht në tërësinë e saj, në qoftë se nga e gjithë zona e kontratës është hequr dorë ose nëse periudha e zhvillimit dhe e prodhimit, ose ndonjë zgjatje e mëtejshme ka mbaruar në përputhje me nenin 3.5 dhe 3.7.

## Neni 30 **Kontroll-revizionet**

AKH-ja do të ketë një periudhë prej gjashtë (6) muajsh kohë nga marrja e ndonjë raporti të rikuperimit të kostos në përputhje me procedurën llogaritëse, në të cilën të kontrollojë dhe të ngrejë objeksione për ndonjë raport të rikuperimit të kostos. AKH-ja dhe Kontraktori do të bien dakord për korrigjimet e kërkuara. Dokumentet mbështetëse dhe llogaritë do të jenë të disponueshme për AKH-në gjatë periudhës së thënë prej gjashtë (6) muajsh. Në qoftë se brenda periudhës së kohës kufi prej tre (3) muajsh pas mbarimit të gjashtë (6) muajve të mësipërm, AKH-ja nuk ka lajmëruar Kontraktorin për parregullsitë e tij të një raporti të tillë, ky raport do të konsiderohet i aprovuar.

## Neni 31 **Parashikime të përgjithshme**

### 31.1 Njoftimet

a) Njoftimet dhe komunikimet e tjera të kërkuara ose të lejuara që të bëhen sipas kësaj kontrate, do të konsiderohen të dhëna kur jepen ose merren me shkrim dorazi ose nëpërmjet postës, ose të transmetuara me faks, të adresuara në mënyrë të përshatshme si më poshtë:

AKH:

i) dorazi ose me postë:

Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve

Në vëmendje të: Drejtorit Ekzekutiv

Rruga e Elbasanit

Fakulteti Gjeologji-Miniera, Godina e Re, kati I

Tiranë, Shqipëri

ii) me faks + +355-4 -234 031

Kontraktorit:

i) dorazi ose me postë:

OMV (ALBANIEN) Adriatic Sea Exploration GmbH

Në vëmendje të: Menaxherit të Përgjithshëm

Rruga Dëshmorët e 4 Shkurtit, nr.5, kati 2

Tiranë, Shqipëri

ii) me faks:

+ +355-4-232 108

b) AKH-ja dhe Kontraktori mund ta ndryshojnë adresën ose adresat e tyre duke i dhënë njoftim për ndryshimin njëri-tjetrit.

c) Njoftimet që i jepen Kontraktorit nga AKH-ja do të konsiderohen të dhëna në qoftë se janë dhënë në zyrën e operatorit në Shqipëri.

### 31.2 Përgjegjësia

31.2.1 Kontraktori nuk do të jetë përgjegjës përpara AKH-së, përveç kur personeli supervisor i Kontraktorit është shumë neglizhent në kryerjen e operacioneve hidrokarbure.

31.2.2 Në asnjë rrethanë, Kontraktori nuk do të jetë përgjegjës kundrejt AKH-së për dëmtime-pasoje ose indirekte si humbjet e fitimit ose humbjet e prodhimit.

31.2.3 Në rastin e ndonjë dëmtimi për të cilin Kontraktori quhet përgjegjës në përputhje me nenin 31.2.1, Kontraktori do të marrë përsipër të marrë masat e nevojshme menjëherë dhe në përputhje me praktikën e industrisë ndërkombëtare, për të ulur shkallën e dëmtimit dhe të kthejë operacionet në gjendjen normale. Kontraktori do të paguajë kompensimin e përshtatshëm për dëmtimin për të cilin është deklaruar përfundimisht përgjegjës.

31.2.4 Përveç rastit kur parashikohet ndryshe në mënyrë specifike në këtë kontratë, detyrimet dhe përgjegjësitë e Kontraktorit janë detyrime dhe përgjegjësi të përbashkëta të kompanive. Të drejtat e Kontraktorit mundet, kur konteksti e lejon, të ushtrohen veçmas nga secila prej kompanive.

31.2.5. Kontraktori do të zhvendosë Qeverinë shqiptare, AKH-në dhe punonjësit e tyre, zyrtarët dhe agjentët respektivë, për të gjitha reklamimet nga palët e treta për dëmtimet personale ose dëmtimet e pasurisë si rezultat i kryerjes së operacioneve hidrokarbure, të kryera nga ose në emër të Kontraktorit, duke përfshirë pa kufizim tarifat e arsyeshme të avokatëve dhe kostot e mbrojtjes, me kushtin që Kontraktori nuk do të konsiderohet përgjegjës sipas nenit 31.2.5 për ndonjë dëmtim, pretendim, dëmtim ose plagosje të shkaktuar nga ose si rezultat i ndonjë veprimi neglizhent të Qeverisë shqiptare, AKH-së dhe punonjësve të tyre, zyrtarëve, drejtorëve dhe agjentëve respektivë.

### 31.3 Kërkesa për marrjen e hidrokarbureve

Në rastin e një mungese kritike të hidrokarbureve të disponueshme, shkaktuar nga emergjencë kombëtare për shkak të një konflikti aktiv ose parashikim i afërt i konflikteve, që nuk ekzistojnë në datën efektive, AKH-ja mund të marrë në emër të Qeverisë të gjithë ose një pjesë të prodhimit të zonës së kontratës.

Sasia e hidrokarbureve që kërkohet do të merret në një mënyrë jodiskriminuese nga të gjitha vendburimet në Republikën e Shqipërisë.

Marrja do të kërkojë një vendim të Këshillit të Ministrave dhe nuk do të vazhdojë përtej periudhës së një emergjence të tillë. AKH-ja do të bëjë të gjitha përpjekjet e saj që t'i japë Kontraktorit një njoftim me shkrim gjashtë (6) muaj para një marrjeje të tillë.

Çmimi që do t'i paguhet Kontraktorit do të përcaktohet në përputhje me nenin 13. Paga do të bëhet në dollarë amerikanë dhe brenda tridhjetë (30) ditëve pas mbarimit të çdo muaji për volumnin e marrë gjatë çdo muaji.

Sapo rrethanat që kanë çuar në marrjen pushojnë së vepruari dhe, në qoftë se AKH-ja është në pamundësi pagese në atë kohë, Kontraktori do të ketë të drejtën të marrë pjesën e AKH-së të naftës bruto të vlerësuar në përputhje me nenin 13 në vend të pagimit, derisa shumat e papaguara, duke përfshirë interesat e mbledhur, të llogaritura në përputhje me nenin 20.6, të jenë rikuperuar plotësisht nga Kontraktori.



#### 31.4 Gjuha e tekstit

Kjo kontratë është bërë e ka hyrë në fuqi në gjuhën angleze dhe atë shqiptare. Në rastin e një mospërputhjeje ndërmjet variantit anglisht dhe atij në shqip, varianti në anglisht do ta udhëheqë këtë kontratë.

#### 31.5 Hyrja në fuqi

Kjo kontratë do të jetë ligjërishit detyruese në dhe nga data efektive.

#### 31.6 E gjithë Marrëveshja

Kjo kontratë (së bashku me ndonjë dokument që referohet në të) përbën të gjithë marrëveshjen ndërmjet Palëve dhe zëvendëson çdo marrëveshje të mëparshme, marrëveshje mirëkuptimi, prezantim, marrje përsipër ose garanci midis Palëve në lidhje me subjektin e kësaj kontrate.

#### 31.8 Garancia e kompanisë mëmë

Çdo kompani merr përsipër që kompania e vet mëmë të ekzekutojë një garanci për pjesën e saj të programit minimum të kërimit këtu në një formë të tillë siç është përcaktuar në aneksin "D". Kompanitë dhe AKH-ja bien dakord që të gjitha garancitë e kompanive mëmë duhet të jenë marrë nga AKH-ja pas ekzekutimit të kësaj kontrate nga palët këtu, por para se AKH-ja t'ia paraqesë këtë kontratë Këshillit të Ministrave për aprovim.

#### 31.9 Anekset

Anekset A,B dhe C janë një pjesë e pandashme e kësaj kontrate dhe do të konsiderohen me efekt dhe forcë të njëjtë me klauzolat e pjesës kryesore të kësaj kontrate. Megjithatë, në rastin e një konflikti midis pjesës kryesore dhe ndonjë prej anekseve, klauzolat e pjesës kryesore do të mbizotërojnë.

#### 31.10 Ndryshimet

Asnjë ndryshim i kësaj kontrate nuk do të jetë efektiv, në qoftë se nuk do të bëhet me shkrim dhe të firmoset nga palët.

#### 31.11 Heqjet dorë

Dështimi i ndonjëres nga Palët për të ushtruar ndonjë nga të drejtat e parashikuara në këtë kontratë nuk do të jetë ose nuk do të konsiderohet të jetë një heqje dorë nga një e drejtë e tillë.

#### 31.12 Autoriteti

Çdo njësi e cila është një nënshkruese e kësaj kontrate, i garanton të tjerët që ai ka fuqi dhe autoritet të plotë të hyjë në këtë kontratë dhe që kjo kontratë përbën një detyrim ligjor, të vlefshëm dhe detyrues për të.

Si dëshmi e kësaj, Palët kanë hyrë në këtë kontratë në datën e shkruar më sipër.

Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës

Viktor Doda

OMV (ALBANIEN) Adriatic Sea Exploration GmbH

Lundin Netherlands BV

### ANEKSI A ZONA E KONTRATËS

#### KOORDINATA GJEODEZIKE TË BLOKUT TË RI DETAR NË SHQIPËRI

1. 41°35' 20. 0"N                      19° 26' 40. 0" E

2. 41°35' 20.0"N                      19° 09' 00. 0" E

3. 40° 59' 00. 0" N                      19° 09' 00. 0" E

4. 40° 59' 00.0" N                      18° 56' 00. 0" E

5. 40° 25' 20.0"N                      18° 56' 00.0" E

6.  $40^{\circ} 25' 20.0''$  N                       $19^{\circ} 17' 25.0''$  E
7.  $40^{\circ} 25' 20.0''$  N                       $19^{\circ} 21' 36.0''$  E
8.  $40^{\circ} 25' 20.0''$  N                       $19^{\circ} 29' 23.0''$  E

Shpjegime.

Pika 1: Kjo pikë reflekton ndërprerjen e paralelit  $41^{\circ} 35' 20.0''$  N me nivelin më të lartë të ujërave në vijën bregdetare të detit Adriatik.


Pika 6: Kjo pikë reflekton ndërprerjen e paralelit  $40^{\circ} 25' 20.0''$  N me nivelin më të lartë të ujërave në vijën bregdetare të detit Adriatik në bregun perëndimor të gadishullit të Karaburunit.

Pika 7: Kjo pikë reflekton ndërprerjen e paralelit  $40^{\circ} 25' 20.0''$  N me nivelin më të lartë të ujërave në vijën bregdetare të detit Adriatik në bregun lindor të gadishullit të Karaburunit.

Pika 8: Kjo pikë reflekton ndërprerjen e paralelit  $40^{\circ} 25' 20.0''$  N me nivelin më të lartë të ujërave në vijën bregdetare të detit Adriatik në bregun perëndimor të gjirit të Vlorës.

Vija midis pikave 8 dhe 1 reflekton nivelin më të lartë të ujërave në vijën bregdetare të detit Adriatik dhe vija midis pikave 6 dhe 7 reflekton nivelin më të lartë të ujërave në vijën bregdetare të gadishullit të Karaburunit.

### ANEKSI B



## ANEKSI C PROCEDURA LLOGARITËSE

Ky aneks "C" është bashkëlidhur me dhe është pjesë e kontratës midis AKH-së dhe Kontraktorit.

### Neni 1

#### **Klauzola të përgjithshme**

Kjo procedurë llogaritëse aplikohet dhe do të përdoret në përcaktimin, mbajtjen dhe kontrollin e të gjitha llogarive, librave dhe regjistrimeve të llogarive sipas kësaj kontrate.

Kontrata dhe kjo procedurë llogaritëse janë bërë me qëllim që të jenë të lidhura dhe reciprokisht shpjeguese. Megjithatë, në qoftë se del ndonjë mospërputhje, atëherë klauzolat e kontratës do të mbizotërojnë.

#### 1.1 Përkufizimet

1.1.1 Termat e përdorur në këtë procedurë llogaritëse do të kenë të njëjtin kuptim, ashtu si dhe të njëjtat terma të kontratës.

1.1.2 "Materiale të kontrollueshme" do të thotë materialet, të cilat Kontraktori i vë nën kontroll dhe inventar, në përputhje me praktikën e mira ndërkombëtare të industrisë së naftës.

1.1.3 "Material" do të thotë ndonjë pajisje, makineri, materiale, artikuj, furnizime dhe artikuj të konsumueshëm të blerë, të marrë me qira ose të transferuar nga Kontraktori dhe të përdorur në operacionet hidrokarbure.

#### 1.2 Librat dhe regjistrimet

Librat dhe regjistrimet e llogarive, duke përfshirë taksën, do të mbahen në përputhje me parimet e pranuar përgjithësisht të kontabilitetit, me praktikën dhe procedurat moderne të industrisë së naftës dhe me klauzolat e kësaj kontrate në gjuhën angleze dhe në dollarë amerikanë, të plotësuar dhe të mbështetura në libra të tillë

#### 1.3 Rishikimi i procedurës llogaritëse

Me marrëveshje reciproke ndërmjet ministrisë dhe Kontraktorit, kjo procedurë llogaritëse mund të rishikohet kohë pas kohe, në dritën e rregullimeve të ardhshme.

### Neni 2

#### **Kostot e operacioneve hidrokarbure**

#### 2.1 Kostot e operacioneve hidrokarbure

Palët do të mbajnë një llogari kostoje në të cilën do të reflektohen të gjitha kostot e operacioneve hidrokarbure.

Këto kosto të operacioneve hidrokarbure do të jenë të rikuperueshme nga Kontraktori në përputhje me klauzolat e kësaj kontrate dhe siç do të përcaktohet më poshtë. Pa kufizuar natyrën e përgjithshme të sa më poshtë, kostot dhe shpenzimet të marra në konsideratë nga 2.2 në 2.22 këtu më poshtë përfshihen në kostot e operacioneve hidrokarbure.

Kostot e operacioneve hidrokarbure, duke përfshirë të gjitha ato të grumbulluara përpara fillimit të prodhimit komercial, do të jenë plotësisht të rikuperueshme pa amortizim duke filluar a) në tremujorin në të cilin këto kosto janë krijuar ose b) në periudhën që vjen pas fillimit të prodhimit komercial, cilado që ndodh më vonë.

#### 2.2 Puna dhe kostot e lidhura me të

2.2.1 Kostot aktuale të të gjithë punonjësve të operatorit dhe kostot e personelit të caktuara ose përkohësisht të caktuara, ose të marra me qira nga operatori. Këto kosto do të përfshijnë, por pa u kufizuar në:

a) rrogat bruto dhe shpërblimet ose pagat;

b) kostoja e kohës së tepërt, ditët e pushimit, pushimet, sëmundjet, përfitimet e paaftësisë dhe pagesa të tjera të përditshme të aplikueshme në pagat dhe pagesat të ngarkuara si në (a) më sipër;

c) shpenzimet, taksat dhe pagesa të tjera, në qoftë se ka ndonjë, të bëra në përputhje me vlerësimet ose detyrimet e vendosura nga autoriteti ministral, cilat janë të aplikueshme në koston e pagave dhe pagesave të ngarkueshme si në (a) më sipër;

d) kostoja e planeve të caktuara për sigurimin e jetës së punonjësve, shtrimet në spital, pensionet, kursimet dhe planet e tjera të të njëjtës natyrë përfitimi të aplikueshme në pagat dhe pagesat të ngarkueshme si në (a) më sipër;

e) kostot e transportimit dhe të rivendosjes dhe kostot e transportimit të punonjësve dhe familjeve të këtyre punonjësve (kufizuar në bashkëshorten dhe fëmijët në ngarkim) dhe shërbyesen statutore ose të përditshme për operatorin;

f) të gjitha kostot e udhëtimeve dhe të rivendosjes së punonjësve dhe familjeve të tyre në dhe nga atdheu i punonjësve ose vendi i origjinës në kohën e punësimit dhe për pushime;

g) kostot e akomodimit për punonjësit;

h) shpërblimet, koha mbi atë normale të punës, pagesat e përditshme dhe përfitimet, të cilat do të jenë të aplikueshme për punonjësit vendas në Republikën e Shqipërisë, të gjitha të ngarkueshme sipas (a) më sipër.

### 2.3 Shpenzimet e trajnimit (kualifikimit) të punonjësve

Shpenzimet e kualifikimit për punonjësit e operatorit ose të caktuara, ose përkohësisht të caktuara, ose të marra me qira nga operatori dhe kontributi i Kontraktorit për kualifikimin sipas nenit 15 të kontratës.

### 2.4 Materialet

#### 2.4.1 Kostoja e materialeve do të ngarkohet në llogarinë e koston, bazuar si më poshtë.

Kontraktori nuk garanton për materialet. Të vetmet garanci janë garancitë e dhëna nga prodhuesit ose shitësit, për sa kohë ato janë në fuqi.

2.4.1.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në pjesën 2.4.1.2 më poshtë, materialet do të ngarkohen me koston aktuale neto të kryer nga Kontraktori sipas çmimit të faturës së shitësit, shpenzimeve të paketimit, transportimit, ngarkimit dhe shkarkimit, kostove të asiguracionit, tarifave, pagesave dhe taksave të aplikueshme, në qoftë se ka, duke zbritur të gjitha uljet e çmimit që mund të bëhen aktualisht.

2.4.1.2 Materialet do të ngarkohen me çmimin e specifikuar më poshtë:

a) Materiale të reja (Kushti "A") do të vlerësohen në koston aktuale ndërkombëtare neto, e cila nuk do të kalojë çmimin mbizotërues në transaksione normale të ftohta në tregun e hapur.

b) Materiale të përdorura (Kushtet "B", "C" dhe "D" dhe materialet mbeturina):

i) Materiale të cilat janë në kushte të përdorshme dhe janë të përshtatshme për ripërdorim pa rikondicionim, do të klasifikohen si kushti "B" dhe do të vlerësohen me shtatëdhjetë e pesë për qind (75%) të çmimit aktual të materialit të ri të përcaktuar në (a) më sipër.

ii) Materiale të cilat nuk mund të klasifikohen si kushti "B", por të cilat pas rikondicionimit do të jenë akoma të përdorshme për funksionin e tyre origjinal, do të klasifikohen si kushti "C" dhe do të vlerësohen me pesëdhjetë për qind (50%) të çmimit aktual për materiale të reja siç përcaktohet në (a) më sipër. Kostoja e rikondicionimit do të ngarkohet në materialet e rikondicionuara, duke pasur parasysh që vlera e materialit të kushtit "C", plus koston e rikondicionimit nuk do ta kalojë vlerën e materialit të kushtit "B".

iii) Materialet që kanë një vlerë që nuk mund të përdoret për funksionin e tyre origjinal dhe të cilat për këtë arsye nuk mund të klasifikohen si kushti "B" ose kushti "C", do të klasifikohen si kushti "D" me çmimin e vlerës të barabartë me përdorimin e tij.

iv) Materialet të cilat janë të papërdorshme dhe që nuk mund të klasifikohen si kushti "B" ose kushti "C" ose kushti "D", do të klasifikohen si mbeturina dhe do të konsiderohen që nuk kanë më vlerë.

#### 2.4.2 Inventaret

Në intervale të arsyeshme, të paktën çdo vit, do të bëhen inventare nga Kontraktori e të gjitha materialeve të kontrollueshme. Kontraktori do të japë njoftim me shkrim tridhjetë (30) ditë para për qëllimin që ka për të kryer një inventar të tillë, për ta lejuar AKH-në të zgjedhë nëse do të jetë e përfaqësuar kur të kryhet inventari ose të mos jetë prezent. (Rast në të cilin AKH-ja do të zgjedhë të pranojë inventarin e kryer nga Kontraktori.)

## 2.5 Shpenzimet indirekte

Shpenzimet administrative të bazës dhe pajisjeve si të bazës tokësore, magazinave, sistemit të ujit, sistemit të rrugëve, pagat dhe shpenzimet e personelit supervisor fushor, nëpunësve fushorë, asistentëve dhe punonjësve të tjerë të përgjithshëm që i shërbejnë indirekt zonës.

## 2.6 Transportimi

Transportimi i materialeve dhe kosto të tjera të lidhura me të, duke përfshirë, por pa u kufizuar në shërbimet e origjinës, dërgesave, paketimit, tarifën portuale, pagesa e dërguesit, dërgesave tokësore dhe ajrore dhe procedurave doganore dhe procedura të tjera të destinuara.

## 2.7 Shërbimet

2.7.1 Kostot aktuale të kontratave të shërbimit, konsulentëve profesionistë dhe shërbime të tjera të kryera nga palë të treta.

2.7.2 Kostot e përdorimit të ambienteve ose pajisjeve brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë për përfitimin direkt të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga Kontraktori ose filialet e kompanive ose palëve të treta, me çmime të njëjta me koston e zotërimit ose qirasë dhe koston e operacionit.

## 2.8 Shpenzimet administrative dhe të përgjithshme në Republikën e Shqipërisë

Në kohën që Kontraktori është duke kryer aktivitet sipas marrëveshjes, kostoja e stafit dhe e mirëmbajtjes së zyrës qendrore të operatorit në Republikën e Shqipërisë dhe/ose zyra të tjera të hapura në Republikën e Shqipërisë siç është e përshtatshme, përveç zyrave fushore të cilat do të ngarkohen siç parashikohet në nenin 2.5 më sipër, dhe duke përjashtuar pagat e punonjësve të operatorit, të cilat janë përkohësisht caktuar dhe që shërbejnë direkt në zonë, të cilat do të ngarkohen siç parashikohet në nenin 2.2 më sipër. Këto kosto do të ngarkohen në koston e operacioneve hidrokarbure.

Në rastin kur këto kosto të personelit dhe zyrës së operatorit ose filialeve të operatorit nuk i atribuohen plotësisht operacioneve hidrokarbure, atëherë këto kosto do të ngarkohen mbi një bazë të njëjtë.

## 2.9 Shpenzimet administrative të qendrës

Shpenzimet administrative të kompanisë mëmë të Operatorit jashtë Republikës së Shqipërisë që aplikohen për operacionet sipas kontratës, do të ngarkohen çdo muaj në përputhje me nivelet e mëposhtme:

Në qoftë se shuma kumulative e të gjitha shpenzimeve për vitin kalendarik është më pak ose e barabartë me 5 000 000 00 US\$ (pesë milionë dollarë amerikanë), atëherë do të aplikohet një vlerë prej 5% për shpenzimet administrative të qendrës.

Në qoftë se shuma kumulative e të gjitha shpenzimeve për vitin kalendarik e kalon shumën e 5 000 000.00 US\$ (pesë milionë dollarë amerikanë), por është më pak ose e barabartë me 10 000 000.00 US\$ (dhjetë milionë dollarë amerikanë) atëherë një nivel prej 3% do të aplikohet për pjesën shtesë të shpenzimeve.

Në qoftë se shuma kumulative e të gjitha shpenzimeve për vitin kalendarik e kalon shumën e 10 000 000.00 US\$ (dhjetë milionë dollarë amerikanë), atëherë një nivel prej 2% do të aplikohet për pjesën shtesë të shpenzimeve.

Minimumi i shumës që do të ngarkohet do të jetë 80 000.00 US\$ (tetëdhjetë mijë dollarë amerikanë) për vit kalendarik.

## 2.10 Taksat

Të gjitha taksat, tarifën ose pagesat të paguara në Republikën e Shqipërisë nga Kontraktori në lidhje me këtë Kontratë, përveç atyre të mbuluara nga neni 18 i Kontratës, në qoftë se ka ndonjë.

## 2.11 Të drejtat sipërfaqësore

Të gjitha kostot direkte për marrjen, rinovimin ose heqjen dorë nga të drejtat sipërfaqësore në fuqi në zonë.

## 2.12 Dëmtimet dhe humbjet e materialeve dhe infrastrukturës

Në përputhje me nenin 31.2 të Kontratës, të gjitha kostot ose shpenzimet e nevojshme për riparimin ose zëvendësimin e materialeve ose infrastrukturës që rezultojnë nga dëmtimi ose humbja e shkaktuar nga zjarri, përmbytjet, stuhitë, vjedhjet, aksidentet, ose ndonjë shkak tjetër.

## 2.13 Asiguracioni dhe pretendimet

2.13.1 Kuotat e paguara për siguracionin për mbulimin e rreziqeve të lidhura me operacionet hidrokarbure, në përputhje me praktikat e Kontraktorit ose me ndonjë nga punonjësit e tij dhe/ose të jashtëm, të cilat në përputhje me praktikat ndërkombëtare të naftës, kërkohen nga ligji.

2.13.2 Në përputhje me nenin 31.2 të Kontratës, shpenzimet aktuale të kryera për zgjidhjen e të gjitha humbjeve, pretendimeve, dëmtimeve, gjykimeve dhe shpenzime të tjera (duke përfshirë shpenzimet legale siç përcaktohet më poshtë) në përfitim të operacioneve hidrokarbure.

## 2.14 Shpenzimet legale

Të gjitha kostot ose shpenzimet e mosmarrëveshjeve ose shërbimeve legale për të mbrojtur interesat e Kontraktorit në zonën e kontratës, sipas ose në përputhje me kontratën dhe të nevojshme ose të përshtatshëm duke përfshirë, por pa u kufizuar në tarifatat legale, kostot e arbitrazhit, kostot e gjyqit, kostot e hetimit ose të sigurimit të dëshmive dhe shumat e paguara për zgjidhjen ose kënaqjen e ndonjë mosmarrëveshjeje ose pretendimi. Këto shërbime mund të kryhen nga stafi legal i Kontraktorit dhe/ose një firmë e jashtme, siç mund të jetë e nevojshme, me kushtin që këto kosto nuk lindin nga mosmarrëveshjet e pasuksesshme të Kontraktorit me AKH-në.

## 2.15 Ngarkesat dhe tarifatat

Të gjitha ngarkesat dhe tarifatat të cilat janë paguar nga Kontraktori në lidhje me këtë kontratë.

## 2.16 Zyrat, kampet, pajisje e ambiente të tjera

Kostoja e vendosjes, mirëmbajtjes dhe operimit të ndonjë zyre, kampi, magazine, pajisjeje shtëpiake dhe ambienti tjetër, të tillë si ambienti për shlodhjen e punonjësve. Në qoftë se këto pajisje e ambiente shërbejnë për më shumë se një (1) zonë kontrate, kostot e tyre do të ndahen në baza të barabarta.

## 2.17 Shpenzimet e marrëveshjes së shërbimit

Shpenzimet sipas ndonjë marrëveshjeje shërbimi të bërë ndërmjet Kontraktorit dhe ndonjë nga kompanitë filiale të tij.

## 2.18 Mjedisi

Kostot e kryera për ndonjë nga operacionet e parashikuara në nenin 25.

## 2.19 Abandonimi

Kostot e kryera ose shumat e shpenzuara në përputhje me nenin 27.

## 2.20 Shpenzime të tjera

Subjekt i aprovimit të AKH-së, i cili nuk do të refuzohet në mënyrë të paarsyeshme, ndonjë shpenzim i arsyeshëm i pambuluar ose i patrajtuar në klauzolat e mësipërme, të cilat janë kryer nga Kontraktori, të nevojshme për kryerjen siç duhet të operacioneve hidrokarbure dhe plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës ose të lidhur me të.

## 2.21 Kreditë sipas kontratës

Të ardhurat neto të transaksioneve të mëposhtme do të kreditohen në llogaritë sipas Kontratës:

a) të ardhurat neto të ndonjë siguracioni, në qoftë se kuota ishte kosto e rikuperueshme ose pretendimet në lidhje me operacionet hidrokarbure, ose ndonjë pasuri e ngarkuar në llogaritë sipas kësaj kontrate;

b) të ardhurat e marra nga të jashtëm për përdorimin e pasurive apo pronës ngarkuar llogarive sipas kësaj kontrate, të cilat janë bërë shtesë mbi operacionet hidrokarbure dhe janë dhënë me qira për të ulur humbjet;

c) ndonjë korigjim i marrë nga Kontraktori prej furnizuesve/prodhuesve ose agjentëve të tyre në lidhje me pajisje ose materiale defekte, kostoja e të cilave ishte ngarkuar më parë nga Kontraktori sipas kontratës;

d) qira, rimbursime ose kredi të tjera të marra nga Kontraktori, të cilat aplikohen në ndonjë ngarkesë që i është bërë llogarisë sipas kontratës;

e) të ardhurat nga të gjitha shitjet dhe materiale shtesë të ngarkuara në llogari sipas kontratës, në shumën neto të mbledhur aktualisht.

## 2.22 Mosdublikimi i ngarkesave dhe kredive

Pavarësisht nga ndonjë klauzolë e kundërt në këtë procedurë llogaritëse, qëllimi i saj është që të mos ketë duplikim të ngarkesave ose kredive në llogari sipas kontratës.

### Neni 3

#### **Raportet financiare për AKH-në**

3.1 Detyrimet e raportimit që parashikohen në këtë pjesë do të aplikohen për Kontraktorin dhe do të jenë në mënyrën që tregohet më poshtë.

3.2 Kontraktori do t'i paraqesë AKH-së brenda tridhjetë (30) ditëve pas fundit të çdo tremujori:

3.2.1 Një raport të shpenzimeve dhe të të ardhurave sipas kontratës të analizuara nga artikujt e buxhetit që tregojnë:

- a) shpenzimet dhe të ardhurat aktuale për tremujorin në diskutim;
- b) shpenzimet aktuale kumulative deri në atë datë;
- c) ndryshimet ndërmjet shpenzimeve të buxhetit dhe atyre aktuale dhe shpjegimet për këto.

3.2.2 Një raport të rikuperimit të kostos që përmban informacionin e mëposhtëm:

a) kostot e operacioneve hidrokarbure të rikuperueshme, të mbartura nga tremujori i mëparshëm, në qoftë se ka ndonjë;

b) kostot e operacioneve hidrokarbure të rikuperueshme të kryera gjatë tremujorit, ku për qëllime të rikuperimit të kostos, pasuritë fizike do të kenë prioritet mbi balancën e kostove të operacioneve hidrokarbure të mbetura;

c) kostot totale të rikuperueshme të operacioneve hidrokarbure për tremujorin (a) plus (b) si më sipër;

d) sasia dhe vlera e naftës kosto të marrë dhe të disponuar në mënyrë të ndarë nga Kontraktori për tremujorin;

e) sasia e hidrokarbureve të rikuperuara për tremujorin;

f) sasia e kostos së rikuperueshme të operacioneve hidrokarbureve që do të mbartet në tremujorin tjetër, në qoftë se ka.

3.3 Pas fillimit të prodhimit Kontraktori, brenda tridhjetë (30) ditëve pas mbarimit të çdo tremujori, do t'i paraqesë një raport prodhimi AKH-së, që tregon sasinë e hidrokarbureve nga zona e zhvillimit dhe e prodhimit:

a) të mbajtur stok në fillim të muajit;

b) të prodhuar gjatë muajit;

c) të marrë dhe nga kush;

d) të humbur dhe të konsumuar në operacionet hidrokarbure;

e) të mbajtur stok në fund të muajit.

### Neni 4

#### **Radha e rikuperimit të kostove**

4.1 Kostot e operacioneve hidrokarbureve do të rikuperohen nga prodhimi i naftës brut. Në rast se rikuperimi i plotë i kostove të operacioneve hidrokarbure nuk është realizuar dot gjatë tremujorit respektiv, atëherë për të rikuperuar kostot do të përdoret prodhimi i gaz-kondensatit e me radhë edhe prodhimi i gazit natyror.

4.2 Për sqarim, shembulli llogaritës këtu më poshtë sqaron procedurën në përputhje me këtë kontratë.

ANEKSI D  
GARANCIA E KOMPANISË MËMË

Blloku Durrës

Ndërsa .....("Kompania") së bashku me .....  
dhe.....ka hyrë në një kontratë me ndarje prodhimi për kërkimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në bllokun Durrësi, në detin shqiptar, me datën..... 2004 ("Kontrata"); ndërsa..... një kompani e organizuar dhe që ekziston sipas ligjeve të .....me zyrat e tij të regjistruara në ..... në zotëron direkt ose indirekt 100% të aksioneve të kompanisë ( Kompania mëmë);

ndërsa në përputhje me termat e kontratës, kompania merr përsipër t'i paraqesë AKH-së një garanci të ekzekutuar nga kompania e saj mëmë në një formë të tillë siç tregohet më poshtë ("Garancia e kompanisë mëmë");

ndërsa kompania mban..... për qind (..... %) interesa pjesëmarrje në të drejtat, privilegjet dhe detyrimet e Kontraktorit sipas kontratës;

ndërsa, AKH-ja dëshiron që pjesa e detyrimeve të kompanisë, si një nga kompanitë që përbëjnë Kontraktorin, në lidhje me detyrimin minimal të punës dhe shpenzimet minimale të kërkuara për operacionet kërkimore në përputhje me nenin 6 të kontratës (që këtu më poshtë do të referohet si "Detyrimet") të garantohen nga kompania mëmë;

ndërsa, kompania mëmë është e vetëdijshme që është plotësisht e ndërgjegjshme për masën e detyrimeve të kompanisë sipas kontratës dhe këtu bie dakord, duke marrë në konsideratë pjesëmarrjen e kompanisë në dhe sipas kontratës, të sigurojë dhe të ketë garanci të kompanisë mëmë, siç kërkohet sipas kontratës.

Tani, prandaj këtu dhënë si më poshtë:

1. Subjekt i klauzolave 3 dhe 6 më poshtë, kompania mëmë, në mënyrë të parevokueshme i garanton AKH-së pagesën e çdo shume që duhet paguar nga kompania, sipas kontratës, si rezultat i mosplotësimit nga kompania të detyrimeve të saj.

2. Kjo garanci e kompanisë mëmë lëshohet, me qëllim që të plotësohen kërkesat e garancisë, në lidhje me pjesën e interesave të pjesëmarrjes së kompanisë sipas kontratës dhe do të jetë e disponueshme dhe efektive në datën efektive të kontratës dhe do të përfundojë në ditën e fundit në të cilën Kontraktori ka plotësuar detyrimet e tij për periudhat respektive të kërkimit në përputhje me nenin 6.7, 6.8, 6.9 ose 6.12 të kontratës siç mund të jetë rasti.

3. Shuma maksimale, e llogaritur në përputhje me nenin 6.8 të Kontratës, për të cilën kompania mëmë mund të quhet përgjegjëse gjatë periudhës së parë të kërkimit do të jetë tre milionë e treqind mijë dollarë amerikanë (US\$ 3 300 000. 00).

Në qoftë se kompania zgjedh të hyjë në periudhën e dytë të kërkimit, shuma maksimale për të cilën kompania mëmë do të jetë përgjegjëse është shtatëqind e pesëdhjetë mijë dollarë amerikanë (US\$ 750 000 00).

Në qoftë se kompania zgjedh të hyjë në periudhën e tretë të kërkimit, shuma maksimale për të cilën kompania mëmë do të jetë përgjegjëse, është një milion e dyqind e pesëdhjetë mijë dollarë amerikanë (US\$ 1 250 000.00).

4. Në rastin kur kompania ia jep interesat e pjesëmarrjes së saj, sipas kontratës, një filiali të kompanisë, kjo garanci e kompanisë mëmë do të vazhdojë të jetë në fuqi dhe do të aplikohet *mutatis mutandis* për detyrimet e një filiali të tillë. Në qoftë se kompania ia jep të gjitha interesat e pjesëmarrjes së saj një pale të tretë, kjo garanci e kompanisë mëmë nuk do të ketë më efekt, dhe të gjitha detyrimet e kompanisë mëmë do të përfundojnë në datën që kalimi i interesave do të miratohet nga AKH-ja.

Në qoftë se kompania ia jep një pjesë, por jo të gjitha interesat e saj, një pale të tretë, kompania mëmë në datën që transferimi i interesave aprovohet nga AKH-ja, do të çlirohet nga detyrimet e përcaktuara këtu, në masën e interesave të pjesëmarrjes të transferuara dhe përgjegjësitë e kompanisë mëmë do të reduktohen në mënyrë respektive.



5. Dështimi ndonjë herë nga ana e AKH-së në kërkimin e kryerjes nga ana e kompanisë mëmë të ndonjë detyrimi të parashikuar këtu, në asnjë mënyrë nuk do të ndikojë në të drejtën e AKH-së më vonë ta kërkojë të njëjtën gjë për ndonjë dështim të mëvonshëm të Kontraktorit dhe as nuk do të ndikojë në të drejtën e AKH-së për ta detyruar atë të plotësojë ndonjë klauzolë tjetër të kësaj garancie të kompanisë mëmë.

6. Aty ku plotësimi i detyrimeve të kompanisë pezullohet si rezultat i forcës madhore ose siç parashikohet ndryshe në kontratë, detyrimet e kompanisë mëmë sipas kësaj garancie të kompanisë mëmë, do të pezullohen në mënyrë të njëjtë.

7. Termat e përdorur në këtë garanci të kompanisë mëmë, të cilat janë përcaktuar në kontratë, do të kenë kuptimin që u jepet atyre në kontratë.

Për gjithë sa më sipër dëshmohet se kjo garanci e kompanisë mëmë nënshkruhet nga një zyrtar i autorizuar nga..... në..... ditë të..... 2004.

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;
  - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

LISTA E BOTIMEVE TË AZHURNUARA DERI NË JANAR 2004
---

1.	KUSHTETUTA	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI I PROCEDURËS PENALE	600
4.	KODI PENAL	400
5.	KODI I PUNËS	500
6.	KODI I FAMILJES	450
7.	KODI CIVIL	1000
8.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
9.	KODI ZGJEDHOR	355
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI
---------------------------

11.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
12.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000

BOTIME TË REJA
----------------

13.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	500
14.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL	600

DOLI NGA SHTYPI

PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500
PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E DREJTËSISË	400

Doli nga shtypi më 21.9.2004

Tirazhi: 4500 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2004

Çmimi 150 lekë